



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji informacioni dhe aplikime informatike” me profile “Specialist rrjetesh kompjuterike”, “Teknik për pajisje elektronike” dhe “Teknik për software dhe digitalizim”**

**i**

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Ariana Bejleri
2. Dr. Valma Prifti

Gusht/ 2022

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji informacioni dhe aplikime informatike” me profile “Specialist rrjetesh kompjuterike”, “Teknik për pajisje elektronike” dhe “Teknik për software dhe digjitalizim”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor (Fakulteti i Shkencave Ekonomike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program profesional në “Teknologji informacioni dhe aplikime informatike” me profile: “Specialist rrjetesh kompjuterike”, “Teknik për pajisje elektronike”, “Teknik për software dhe digjitalizim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 214 datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	13 PAE/ 2 PAK v.a (2021- 2022): 9 PAE/ 0 PAK v.a (2020-2021)
18	Numri i studentëve:	123 student totali
19	Komente / të tjera:	-

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional, Teknologji informacioni dhe aplikime informatike me profile "Specialist rrjetesh kompjuterike", "Teknik për pajisje elektronike", "Teknik për software dhe digjitalizim", është një program i realizuar bazuar në legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet rregullatore të UMSH, nën drejtimin e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor.

Ky program ka synim krijimin e teknikëve dhe specialistëve të fushës së Teknologjisë së Informacionit, jo vetëm në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, por dhe më gjerë.

Misioni i DP, TI&AI është të furnizojë tregun me specialistë të munguar të fushës së teknologjisë së informacionit, me bagazh si teorik ashtu edhe praktik. Ky mision është në përputhje me filozofinë e UMSH për të ndërtuar një komunitet mësimi dhe krijimi ku respektohet, vlerësohet dhe besohet cdo pjesëtar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.

Njësia përgjegjëse e angazhuar për organizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit DP, Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile tregon kujdes në plotësimin me e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.

Programi ka 120 kredite (ECTS). Kohëzgjatja e programit është 2 (dy) vjet.

Objektivat kryesorë të programit të studimit Diplomë Profesionale, Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile, janë si më poshtë:

- Ti japi studentëve aftësi komunikuese si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve teknike që kanë të bëjnë me softweret, hardware-et, rrjetat, platformat cloud etj.
- Ti japi studentëve aftësi që të sigurojnë mirëfunksionimin e infrastruktures së rrjetit të Teknologjisë së Informacionit dhe sigurimin e rrjetit sipas standardeve ;
- Ti japi studenteve aftësi që të mirëmbajnë rrjetin kompjuterik duke instaluar programet e duhura, kryer lidhjen me kompjuterin dhe testimet paraprake për funksionimin e tyre;
- Ti japi studentëve njohuri bazë në fushën e teknologjisë së informacionit duke vënë theksin më shumë në formimin e tyre praktik krahas atij teorik;
- Ofron kompetenca teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri, dhe më gjerë.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), është ngritur nga ASCAL me qëllim akreditimin e programit të studimit Diplomë Profesionale në Teknologji Informatike dhe Aplikime Informatike, me profile: “Specialist Rrjetesh Kompjuterike”, “Teknik për Pajisje Elektronike” dhe “Teknik për Software dhe Digjitalizim”.

Anëtarët e GVJ janë zgjedhur në bazë të kompetencave të tyre profesionale, paanshmërisë, mundësisë për të mbledhur dhe aksesuar e përpunuar informacionin e nevojshëm për kryerjen e vlerësimit dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të tyre. GVJ përbëhet nga 2 anëtarë dhe është themeluar vetëm për qëllim të raportit të vlerësimit të jashtëm të programit DP TI&AI.

Procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin DP TI&AI është realizuar nga GVJ në bashkëpunim me ASCAL. Gjithashtu gjatë procesit është përfshirë edhe një vizitë në institucion.

Aktivitetet e kryera në kuadër të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të DP TI&AI nga GVJ janë zhvilluar në bazë të afateve kohore të përcaktuara më parë.

Gjatë kryerjes së procesit, GVJ është udhëhequr nga ruajtja e etikës profesionale dhe zbatimi i kuadrit ligjor mbi aksesin në të dhënat personale dhe konfidencialitetin e tyre.

Në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të DP TI&AI është synuar të jepet një tablo e qartë gjithëpërfshirëse për programin e studimit, duke evidentuar njëkohësisht cilat janë pikat e forta të këtij programi studimi dhe ato që duhen përmirësuar në të ardhmen.

Procedura e vlerësimit të jashtëm, është parë si një proces dinamik vlerësimi dhe diskutimi për të paraqitur realitetin dhe njëkohësisht të evidentohen dhe adresohen për zgjidhje problematikat e mundshme.

Për realizimin e këtij raporti, GVJ u mbështet në të gjitha dokumentat e nevojshme të prodhuara nga Institucioni në dosjen e vetëvlerësimit të zhvilluar nga Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" në kuadrin e akreditimit të programit të studimit DP TI&AI me profile “Specialist Rrjetesh Kompjuterike”, “Teknik për Pajisje Elektronike” dhe “Teknik për Software dhe Digjitalizim”. Gjithashtu GVJ u bazua në kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe në dokumenta të veçanta si “Manuali i vlerësimit institucional të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri”, i përgatitur nga ASCAL.

GVJ e ka organizuar punën e tij duke ndarë detyrat për të mundur në mënyrë gjithëpërfshirëse njohjen dhe evidentimin e dokumentave dhe realizimin e raportit.

Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Aviola Bardhi.

Më datë 26/07/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 125/25 Prot., datë 26/07/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UMSH kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 28/07/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 944/1 Prot., datë 29/07/2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

**Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional “në “Teknologji informacioni dhe aplikime informatike” me profile “Specialist rryetesh kompjuterike”, “Teknik për pajisje elektronike” dhe “Teknik për software dhe digjitalizim”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes që në zbatim të Statutit të UMSH-së është hartuar Rregullorja e Organizimit të UMSH-së e cila është në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit të institucionit. Vizioni i UMSH e përcakton atë si lider që ofron potencialin e nevojshëm për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare dhe qendër ekselence për formimin akademik të studentëve. Misioni i UMSH është tu japë studenteve një edukim cilësor të qëndrueshem, ti shërbejë dijes, shkencës dhe të kontribuojë në partneritete me tregun e punës dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, njohuritë që jepen në lëndët dhe veprimtaritë formuese plotësojnë në mënyrë harmonike dhe koherente tërësinë e kërkesave për formim të studentit në përputhje me diplomën që jep programi. GVJ vuri re që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile dhe strategjia e zhvillimit të tij është pjesë e Strategjisë për Zhvillim të Institucionit, në funksion të realizimit të misionit të tij.</p> <p>Gjithashtu qëllimi, objektivat dhe strategjia e programit janë në përputhshmëri të plotë me qëllimin dhe vizionin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij programi. Drejtimit prioritar akademike të UMSH në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe transferimit të dijeve tek të tretët vumë re që hartohen në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të UMSH-së.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH, neni 7, neni 43; Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH, vizioni, misini; Evidenca 6. Strategjia e Zhvillimit të Programit DP, TI&amp;AI me profile)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në Statutin e UMSH-së, në Planin Strategjik dhe Rregulloren e UMSH-së shprehen qartë drejtimit prioritar akademike të Universitetit në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve tek të tretët.</p> <p>Gjithashtu strategjia e zhvillimit të programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, si pjesë e strategjisë së përgjithshme të</p>

	<p>institucionit garanton përputhshmërinë e objektivave në nivel institucional, duke i harmonizuar me tregun e punës.</p> <p>Misioni i DP, TI&amp;AI është të furnizojë tregun me specialistë të munguar të fushës së teknologjisë së informacionit, me bagazh si teorik ashtu edhe praktik.</p> <p>Ky mision është në përputhje me filozofinë e UMSH për të ndërtuar një komunitet mësimi dhe krijimi ku respektohet, vlerësohet dhe besohet cdo pjesëtar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.</p> <p>UMSH ka për qëllim të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme të bazuara në kërkim dhe njohuri shkencore, dhe në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës ka për qëllim të ofrojë edhe programe studimi afatshkurtra për kualifikime e specializime si dhe përditësim të dijeve.</p> <p>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu I, Neni 5; Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH; Evidenca 6. Strategjia e Zhvillimit të Programit DP, TI&amp;AI, me profile pika 4)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/ kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile, është në përputhje të plotë me drejtimet që institucioni ofron programet e studimit, me fushën e ekspertizës së personelit akademik të DIFSH-it, FSHE-së dhe me gjithë veprimtarinë kërkimore të institucionit, si në emërtim, organizim, strukturë dhe përmbajtje të tij.</p> <p>GVJ vuri re që misioni dhe objektivat e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile janë në përputhje të plotë me misionin e përgjithshëm të institucionit dhe shprehin qartë filozofinë e tij. Për realizimin e këtij objekti në programin mësimor, institucioni parashikon thellimin e studimeve si në fusha bazë ashtu dhe në ato të specialitetit.</p> <p>Misioni i DP, TI&amp;AI është të furnizojë tregun me specialistë të munguar të fushës së teknologjisë së informacionit, me bagazh si teorik ashtu edhe praktik. Ky mision është në përputhje me filozofinë e UMSH për të ndërtuar një komunitet mësimi dhe krijimi ku respektohet, vlerësohet dhe besohet cdo pjesëtar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.</p> <p>(Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH; Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH; Evidenca 5. Rregullore FSHE, Kreu X, Neni 51, pika 2; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Në këtë institucion, vihet re nga GVJ, që studimi i tregut nëpërmjet anketimit cilësor dhe sasior ka arritur në përfundimin se ky program studimi është i kërkuar nga të punësuarit aktual në sektorin e IT. Për hartimin e programit të studimit dhe hapjen e tij ka pasur një orientim nga</p>

	<p>analiza e kërkesës së tregut të punës për specialistë të teknologjisë së informacionit në profilet e rrjetave, elektronikës dhe programimit. GVJ konstaton që kjo kërkesë ka buruar nga roli i këtyre specialistëve në kompani, biznese dhe në organizata të tjera. Përgjatë viteve të fundit numri i këtyre kompanive dhe organizatave ka ardhur në rritje, duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës. Gjatë kësaj analize u vu re që është përdorur një metodologji e mbledhjes së të dhënave që përfshin analizën e kërkesës e ofertës sipas metodologjisë europiane të studimit të tregut të punës, ku përfshihen si tregues kombëtarë, ashtu edhe tregues të rajonit ballkanik. Bazuar në vëzhgimet e tregut të punës janë evidentuar tre profilet e ofruara nga ky program si më të kërkuarit nga tregu. Ky programi i studimit përmirësohet vazhdimisht duke ndjekur trendin e zhvillimit teknologjik të vendit.</p> <p>(Evidenca 8. Studimi i tregut të punës; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në këtë program studimi, lëndët, kanë të specifikuar qartë një përmbledhje dhe rezultatet që priten, objektivat e lëndës, konceptet themelore që studentët përfitojnë në përfundim të secilës lëndë. Aftësitë, njohuritë apo kompetencat janë përcaktuar për çdo lëndë nisur nga përvoja më e mirë e shkollave në fushën e IT, gjithashtu edhe nga praktika e punës në kompani të ndryshme dhe nga trendet e zhvillimit të profesioneve. Pas përfundimit të studimeve të gjithë të diplomuarit në DP, TI&amp;AI me profil Specialist Rrjetesh Kompjuterikë, Teknik për Pajisje Elektronike dhe Teknik për Software dhe Digjitalizim do të jenë në gjendje të punojnë në çdo kompani ose biznes në fushën e teknologjisë së informacionit, elektronikës dhe programimit. GVJ vuri re që të gjithë të diplomuarit në DP, TI&amp;AI me profil Teknik për Pajisje Elektronike në përfundim të programit do të kenë të gjitha aftësitë për të punuar në kompani elektronike në sektorët e prodhimit, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të pajisjeve elektronike. Të gjithë të diplomuarit në DP, TI&amp;AI me profil Teknik për Software dhe Digjitalizim do mund të punojnë në të gjitha pozicionet ku nevojiten programues të mirëfilltë, programues web-i ose mirëmbajtës web, etj. Në vazhdimësi shihet përmes studimit të tregut të punës dhe feedback-ut që merret nga kompanitë por edhe studentëve të punësuar, se çfarë ndryshime mund të bëhen në vazhdim që të rrisin përputhshmërinë ndërmjet aftësive të marra dhe kërkesave nga kompanitë. Vume re si GVJ edhe gjatë vizitës në institucion që deri tani Dep. i Informatikës dhe formimit shkencor duke shfrytëzuar lidhjet personale të pedagogëve ka organizuar një sërë aktivitete me profesionistë/specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit si edhe me antarë bordi, nga tregu i punës me të cilët departamenti mban kontakte të ngushta.</p>

	(Evidenca 8. Studimi i tregut të punës; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB; Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset)			
<b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Këto kërkesa të tregut të brendshëm për programues ose specialist rjetash në fushën e teknologjisë së informacionit janë gjithmonë në rritje. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit kërkon të diplomuar me përgatitje të lartë profesionale. Në vazhdimësi shihen përmes studimit të tregut të punës dhe feedback-ut që merret nga kompanitë por edhe studentëve të punësuar, se çfarë ndryshime mund të bëhen në vazhdim që të rrisin përputhshmërinë ndërmjet aftësive të marra dhe kërkesave nga kompanitë.</p> <p>U vu re që në projektimin dhe realizimin e studimit janë mbajtur parasysh: të dhënat e INSTAT-it mbi kërkesat e tregut për punësim, sipas profilit që ofrohet; kërkesat e punëdhënësve; të dhënat e MASR-së për fluksin e të diplomuarve në programet profesionale. Gjatë këtij studimi është analizuar kërkesa duke marrë në konsideratë portalet e zyrave të punës, shoqatat e investitorëve, ndryshimet e tregut të punës, numrin e të regjistruarave në IAL-të në këto profile dhe tregues të tjerë për të përlllogaritur në mënyrë të përafërt numrin e studentëve që do punësohen pas mbarimit të programit në këtë profesion. GVJ konstatoi që studimi i tregut përfshin analizën e kërkesës/ofertës sipas metodologjisë europiane të studimit të tregut të punës, ku përfshihen tregues kombëtarë, si edhe tregues të rajonit ballkanik. Vume re si GVJ edhe gjatë vizitës në institucion që deri tani Dep. i Informatikës dhe formimit shkencor ka organizuar një sërë aktivitete me specialistë/profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit nga tregu i punës me të cilat departamenti mban kontakte të ngushta. Psh.tavolina të rrumbullakta (me përfaqësues të biznesit në kuadër të USIA pjesë e një projekti të Erasmus +, aktivitet në kuadër të projektit Equity network- Get connected to empower women and girls in STEM and Research”, me Raiffeisen bank, etj.)</p> <p>(Evidenca 8. Studimi i tregut të punës; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB; Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

**Kriteret****Vlerësimi**

**Kriteri 1.** Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

GVJ konstatoi që program i studimit DP, TI&AI me profile bazohet në Statutin e UMSH, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Departamentit, si dhe Rregulloren e programit të studimit, të cilat garantojnë mbarëvajtjen dhe realizimin me cilësi të programit të studimit. Secila strukturë ka të qarta detyrat dhe kompetencat e përcaktuara qartë në këto akte rregullore. DIFSH-i i FSHE është Njësi përgjegjëse për hartimin, ofrimin, monitorimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Njësitë garantojnë ecurinë e procesit mësimor, mbikëqyrin personelin akademik dhe monitorojnë cilësinë e mësimdhënies në këtë program studimi. Pjesë përbërëse e këtij procesi monitorimi të vazhdueshëm është dhe NJSBSCZHK e cila përmes procedurave të qarta bën vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor. Çdo strukturë/njësi përgjegjëse në linjë vertikale hierarkike ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit respektivë nëpërmjet procedurave përkatëse, si raportimi në Sekretari përmes regjistrin që plotësohet, raportimi në Departament, dhe raportimi në nivel Fakulteti përmes raportit semestral dhe vjetor. GVJ konstatoi që me qëllim sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve të procesit mësimor, studentët plotësojnë në mënyrë konfidenciale edhe një formular për cdo lëndë dhe për pedagogët. Gjithashtu funksionojnë edhe fokus grupet me qëllim ndarjen e ekpëriencave dhe mbledhjen e mendimeve. (Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&AI; Evidenca 5. Rregullore e SHE; Evidenca 9. Rregullore DIFSH; Evidenca 11. Rregullore NJSBSCZHK, Neni 1, Evidenca 24. Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti; Evidenca 23. Procedura e punës me fokus grupet)

**Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj.


GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që objektivat e programit të studimit diktojnë bashkëpunimin e institucionit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. UMSH është i vetmi institucion akademik shqiptar pjesëtar i EMUNI, i institucionit më të rëndësishëm të arsimit të lartë në rajonin Euro-Mesdhetar. <https://www.umsh.edu.al/c/53/anetar-i-emuni> Sipas vizionit të tij strategjik dhe duke ndjekur objektivat e tij të ndërkombëtarizimit, UMSH-ja ka një sërë marrëveshesh me Universitete homologe të brendshme dhe të jashtme. GVJ nga studimi i listës së marrëveshjeve konstatoi që UMSH ka vendosur marrëdhënie institucionale me marrëveshje me 44 universitete brenda dhe jashtë vendit, me 6 institute, me 21 biznese private, 13 institucione shtetërore, 2 organizata OJF, 1

	<p>organizatë informuese. Institucioni ka përcaktuar bashkëpunimin si prioritet dhe vendosja e marrëveshjeve bëjnë pjesë në historikun e ngjarjeve shkencore të UMSH-së dhe dëshmojnë për një traditë të konsoliduar kërkimore dhe bashkëpunimi të gjithanshëm. Kjo reflektohet drejtpërdrejt në mundësinë e stafit dhe studentëve për të qenë pjesë e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në aktivitete dhe projekte kërkimi, zhvillimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion që Dep. i Informatikës dhe formimit shkencor ka organizuar një sërë aktiviteteve me specialistë/ profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit nga tregu i punës me të cilët departamenti mban kontakte të ngushta. Psh tavolina të rrumbullakta me përfaqësues të biznesit në kuadër të USIA pjesë e një projekti të Erasmus +, aktivitet në kuadër të projektit Equity network- Get connected to empower women and girls in STEM and Research”, me Raiffeisen bank, etj.</p> <p>(Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Lista e marrëveshjeve që UMSH ka me institucionet akademike dhe joakademike)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ vuri re që DIFSH përgjegjës për këtë program merr pjesë si strukturë ekspertize dhe ekzekutimi të marrëveshjeve të bashkëpunimit që Institucioni ka në mbarëvajtje dhe përfitim të drejtpërdrejtë për programin e studimit që ato ofrojnë. Në mënyrë optimale njësia përkatëse analizon produktin e marrë nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe në bazë të rezultateve vendoset për rëndësinë e tyre. Këto rezultate paraqiten në raportet vjetore që institucioni harton. Institucioni dhe njësia përgjegjëse janë në kërkim të vazhdueshëm të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve potencialë. Me përfundimin e këtij viti, si vit brezi i parë edhe i praktikave në fund të vitit të dytë si edhe nga praktikat në vit të parë, do të shihen edhe mundësitë për shtim të marrëveshjeve apo komunikim për një përfitim sa më të mirë nga këto marrëveshje. GVJ konstatoi që deri tani studentët dhe stafi janë të kënaqur me këto bashkëpunime me kompanitë. GVJ nga studimi i listës së marrëveshjeve konstatoi që UMSH aktualisht ka vendosur marrëdhënie institucionale me marrëveshje me 44 universitete brenda dhe jashtë vendit, me 6 institute, me 21 biznese private, 13 institucione shtetërore, 2 organizata OJF, 1 organizatë informuese.</p> <p>(Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Aneksi 1 Tabelat përmbledhëse të programit të studimit / Tabela 5. Lista e marrëveshjeve midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe">https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe</a>; Lista e marrëveshjeve që UMSH ka me institucionet akademike dhe joakademike, pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ vuri re që UMSH disponon personel akademik me kohë të plotë të mjaftueshëm dhe mbulon të gjitha detyrimet përsa i përket realizimit të praktikave profesionale. Duke u bazuar në strategjinë e programit të studimit, objektivave afatgjatë të mësimnxënies, përshtatjes së vazhdueshme ndaj faktorëve të jashtëm institucionalë dhe kapaciteteve në burime njerëzore, Departamenti përkatës i ofrimit të programit, në koordinim të plotë me UMSH-në, praktikën e studentëve të këtij programi e aplikojnë me orë intensive në auditor ku studentët mësojnë të përdorin programet kompjuterike të programimit dhe elektronikës, mësojnë se si të përgatiten në prezantimet e para me tregun e punës nëpërmjet intervistave të simuluar, bëjnë së një letre motivimi dhe një CV-je të formatit bashkëkohor. Marrëveshjet e nënshkruara nga UMSH-ja me palë të treta janë dakortësuar për të shfrytëzuar ambientet e UMSH-së në dispozicion të lëvrimit të praktikës. UMSH aktualisht ka vendosur marrëveshje me 6 institute, me 21 biznese private, 13 institucione shtetërore, 2 organizata OJF, 1 organizatë informuese.</p> <p>Procedura dhe dokumentacioni shoqëruar janë të përcaktuara në syllabusin dhe udhëzuesin për praktikën shtojca nr. 1 "Udhëzues për praktikën, shkurt 2019" datë 01.09.2020, nr prot: 200804. Nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me institucionet publike dhe private në vend, UMSH- u mundëson studentëve kryerjen e praktikës profesionale sipas specifikimit të degës përkatëse, si pjesë përbërëse e planit mësimor. Në lëndët me natyrë praktike janë angazhuar studentët në punime të nivelit mesatar të dorëzuara përgjatë semestrit.</p> <p>Praktika mësimore realizohet nëpërmjet leksioneve të shpjeguara, rasteve studimore, dhe materialeve ndihmëse të përgatitura nga ekspertet respektivë. Studenti vlerësohet në bazë të një dosjeje. Këtu përfshihen përshkrimi i dijeve të përvetësuara nga orët e praktikës në auditor, hartimi i një letre interesimi për një vend pune, një intervistë pune me shkrim dhe CV e studentit sipas formatit Europass.</p> <p>(Aneks/ 2. Syllabuset e lëndëve të programit/ Syllabusi i praktikës; Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Aneksi 1 Tabelat përmbledhëse të programit të studimit/ Tabela 5. Lista e marrëveshjeve midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera; pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ vuri re që ishin krijuar marrëveshje bashkëpunimi në funksion të studentëve për integrimin e tyre në tregun e punës. UMSH në koordinim me kompanitë që ka marrëveshje, trajnon dhe ofron mundësi studentëve të krijojnë kontakte në botën e teknologjisë së informacionit. Institucioni stimulon edhe vetëpunësimin, organizon seminare për gjetjen e ideve të reja për financimin e start-up-ve. GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion që Dep. i Informatikës dhe formimit shkencor</p>

	<p>gjithashtu ka organizuar një sërë aktivitete me profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit, nga tregu i punës me të cilat departamenti mban kontakte të ngushta. Psh.ishin zhvilluar tavolina të rrumbullakta me përfaqësues të biznesit në kuadër të USIA “ University to Society Innomediaries in Albania, pjesë e një projekti të Erasmus +, aktivitete në kuadër të projektit Equity network- Get connected to empower women and girls in STEM and Research”, takime me Raiffeisen bank për prezantimin e programit më të ri të kësaj banke Key Academy, Leksione të hapura me Ritech Solutions, Prezantimi i platformës ITIL dhe ServiceNow, Siguria kibernetike në Shqipëri, “ Cybersecurity 101”, etj. Gjithashtu janë organizuar në mbështetje të sipërmarrjes dhe studentëve, webinarë si: Women in STEM, Lets talk about data AI and law, digital marketing and e-commerce. Gjithashtu GVJ vuri re që janë organizuar edhe trajnime si psh Trajnimi i studentëve të diplomës profesionale dhe informatikë biznesi në fushën e robotikës dhe programimit në gjuhën Python, në ambientet e laboratorit Albanian ICT Academy.</p> <p>(18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ vuri re bazuar në RVB, dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe vlerësimi në kredite bëhet sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai është i organizuar në lëndë dhe module ku vlerësohen me një numër të caktuar kreditesh sipas tipit të veprimtarisë (A-E) në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile realizohet me ndjekje të mësimin me kohë të plotë, kohëzgjatja është 2 (dy) vite akademike, të përbërë nga katër semestra, me lëndë dhe module duke përfshirë edhe praktikën profesionale. Në përfundim të të cilëve studenti fiton 120 kredite (ECTS), referuar Kornizës Shqiptare të kualifikimeve. Në planin mësimor vihet re përcaktimi i lëndëve sipas semestrave, kreditet përkatëse për cdo lëndë dhe ndarja e krediteve sipas leksioneve, seminareve, ushtrimeve dhe praktikës. Vëmë re që 60 kredite janë realizuar në vitin e parë ku kanë lëndë me trung të përbashket për të tre profilet. Ndërsa 60 kredite janë vendosur në vit të dytë, nga të cilat 30 kredite me trung të përbashket në semestrin e parë dhe nga 30 kredite me</p>



	<p>lëndë të vecanta për secilin profil në semestrin e dytë. (Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimit në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstatoi që në planin mësimor vihet re përcaktimi i lëndëve sipas semestrave, kreditet përkatëse për çdo lëndë dhe ndarja e krediteve sipas leksioneve, seminareve, ushtrimeve dhe praktikës. Vëmë re që 60 kredite janë realizuar në vitin e parë ku kanë lëndë me trung të përbashkët për të tre profilet. Ndërsa 60 kredite janë vendosur në vit të dytë, nga të cilat 30 kredite me trung të përbashkët në semestrin e parë dhe nga 30 kredite me lëndë të vecanta për secilin profil në semestrin e dytë. Ky program përmban lëndë të cilat kanë karakter ndërdisiplinor. Kjo i shërben formimit të gjithëanshëm të studentëve. Programi i studimit përveç lëndëve që përfshihen në disiplina të formimit karakterizues dhe që përbëjnë edhe drejtimin kryesor të programit, përmban edhe lëndë që bëjnë pjesë në disiplina të formimit të përgjithshëm, lëndë të karakterit integruar, lëndë plotësuese dhe lëndë me zgjedhje, të cilat i formojnë studentët, por dhe u krijojnë mundësinë atyre të orientohen drejt një kategorie më të gjerë profesionale e specialitetesh brenda fushës së teknologjisë së informacionit. Vumë re që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile synon nëpërmjet secilës lëndë, t'u japë studentëve njohuritë dhe terminologjinë e duhur profesionale që iu duhet për formimin e tyre profesional. Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë rezultatet e të nxënësve dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde. Gjithashtu objektivat njohëse dhe aftësuese, aftësitë dhe kompetencat janë po ashtu pjesë përbërëse e përmbajtjes së syllabuseve të lëndëve. Në hartimin e programit të studimit të lëndëve është marrë parasysh evoluimi i tregut të punës dhe dinamikat e zhvillimit në vendin tonë. Në fund synohet që studentet të kenë nivel të lartë të njohurive dhe të jenë të përgatitur për tregun e punës. (Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB )</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>GVJ konstatoi që në aktet rregullatore të UMSH-së (rregullore e institucionit, fakultetit, dhe programit të studimit), është shprehur qartësisht profili i programeve dhe gjithashtu edhe njohuritë që ato japin. U vu re nga GVJ që bëhet përditësimi periodik i përmbajtjes së lëndëve me literaturën bashkëkohore. Kjo i ndihmon studentët të njihen me të rejtat më të fundit në fushat përkatëse. Nga pyetjet në institucion dhe RVB u vu re që çdo vit akademik syllabuset rishikohen dhe përmirësohen në përputhje të plotë me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të miratuara nga UMSH-ja si dhe kërkesat e tregut të punës. Përmes takimeve të ndryshme vumë re që ka diskutim mbi programin orientues të studentëve, përcaktimin e lëndëve që do të jenë peshë e programit orientues, etj. Përditësimi i metodave mësimdhënëse dhe dobishmëria praktike e tyre plotësohen me literaturën e nevojshme dhe me materialet didaktike që çdo pedagog depoziton në</p>

	<p>bibliotekën e institucionit. Gjatë vizitës në institucion nga GVJ u vu re depozitimi i materialeve për secilën lëndë nga pedagogët. Tek studentët aplikohen metoda interaktive përgjatë seminareve dhe ushtrimeve dhe merren shembuj të ndryshëm për të zgjidhur probleme të karakterit profesional praktik. Po kështu u vu re që gjatë praktikës të realizuar përmes leksioneve, rasteve studimore dhe materialeve nga ekspertë, përdoren forma të ndryshme duke ndihmuar studentët të përvetësojnë njohuritë praktike si edhe ti zbatojne ato.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 14. Procesverbal mbledhje “Për diskutimin e ndryshimeve në programet e lëndëve dhe miratimin e tyre”; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, mundëson zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të avancuara në fushën e teknologjisë së informacionit të cilat garantojnë zgjidhjen e problemeve komplekse në funksion të profesionit. Këto janë të shprehura edhe në programet e Syllabuseve të lëndëve të këtij programi ku synohet fryma krijuese dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit në lëndët përkatëse. Vume re qe përgatitja e studentëve me aftësi në fushën e teknologjisë së informacionit është një synim parësor për pedagogët gjatë punës me studentët. Në këtë program vumë re që pedagogët aplikojnë metoda të avancuara në zgjidhjen e problematikave. Programi është ndërthurur edhe me njohuritë teorike edhe me aplikimin praktik të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Tek studentët aplikohen metoda interaktive përgjatë seminareve dhe ushtrimeve dhe merren shembuj të ndryshëm. Kjo mënyrë ka synim pajisjen e studentëve me dijet e nevojshme profesionale dhe aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e teknologjisë dhe për të zhvilluar kompetencat për të menaxhuar dhe mbikëqyrur situata të ndryshme.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/ njësia kryesore/ kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>GVJ konstatoi që në programin DP, TI&amp;AI me profile personeli akademik i punësuar me kohë të plotë mbulon pothuajse të gjitha lëndët dhe realizon pjesën më të madhe të orëve mësimore. Nga tabela me nr e personelit akademik për cdo njësi bazë, vëme re që në <b>vitin akademik 2021-2022 departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor ka në total 26 pedagogë nga të cilët, 18/ PAE dhe 8/ PAK. PAE janë 2 me titullin Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 3 Dr., 1 Dr ne Proc, dhe 11 MSc. Ndërsa PAK janë 2 Prof. Dr., 1 Dr, 5 MSc.</b></p> <p>Ndërsa në vitin akademik 2020-2021 departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor ka në total 24-pedagogë nga të cilët, 20/ PAE dhe 4/ PAK. PAE janë 2 me titullin Prof. Dr., 4 Dr., 1 Dr ne Proc, dhe 13 MSc. Ndërsa PAK janë 2 Prof. Dr., 1 Dr, 1 MSc..</p>

	<p><b>Fakulteti i Shkencave Ekonomike bazuar te tabela, ka në total PAE për vitin akademik 2020-2021, 5 Prof Dr., 7 Prof. Asoc., 15 Dr., 3 Dr. Proc., 22 MSc.</b></p> <p>Numri i personelit akademik efektiv në funksion të realizimit të këtij programi studimi është mbi normën e parashikuar nga aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.</p> <p>Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi ka një përvojë akademike të konsiderueshme në mësimdhënie dhe në fushën e kërkimit shkencor. Personeli akademik me kohë të pjesshme që është thirrur për të mbuluar ngarkesën mësimore është përzgjedhur, kryesisht me tituj e grada shkencore dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me procedurat përkatëse të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, fakulteti dhe departamentet angazhojnë si titullarë të lëndëve/ moduleve për programim DP, TI&amp;AI me profile, personel akademik që kanë së paku gradën shkencore “MSc”. Një pjesë e mirë e tyre kanë kryer kualifikime e specializime sipas fushave përkatëse dhe disiplinave që mbulojnë. Për rekrutimin e stafit gjithmonë ka informacion në web dhe përzgjedhja kalon në disa faza. Një pikë e fortë për stafin e brendshëm është zgjedhja e pedagogut në përputhshmëri me programin e studimit. Bëhet trajnim i stafit të ri për dokumentat, për ti njohur. Realizohen pjesëmarrje në konferenca dhe tryeza të rrumbullakta ku ka diskutime për pika të ndryshme.</p> <p>(Aneksi 1. Tabelat përmbledhëse të programit të studimit Tabelat 1, 6.1, 6.2, 7: Të dhënat përmbledhëse për stafin akademik; Aneksi 1. Tabelat përmbledhëse të programit të studimit, Tabela 12: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; pyetjet gjatë vizites në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>GVJ konstatoi që programi i Studimit DP, TI&amp;AI me profile, është hartuar në përputhje me aktet nënligjore dhe aktet rregullatore të UMSH. Ky program ka të përcaktuar qartësisht objektivat për formimin e studentëve, dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Objektivi kryesor i programit të studimit është t’i pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Ky program u vu re që ofron kompetenca teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri, por edhe më gjerë. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e teknologjisë së informacionit për të përgatitur specialistë me njohuri dhe aftësi që të punojnë në profilet përkatëse. Ata përgatiten për të filluar dhe zhvilluar karrierën e tyre në organizata të sektorit privat, të sektorit shtetëror, të atij jofitimprurës. Formimi i tyre i përshtatet kërkesave të Listës Kombëtare të Profesioneve.</p> <p><a href="http://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-profesioneve/lista-e-profesioneve/">http://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-profesioneve/lista-e-profesioneve/</a></p> <p>Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë rezultatet e të nxëniet dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde. Gjithashtu objektivat njohëse dhe aftësuese, aftësitë dhe</p>

	kompetencat janë po ashtu pjesë përbërëse e përmbytjes së syllabuseve të lëndëve. (Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&AI, Neni 4 dhe Neni 5; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit, pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)			
Shkalla e përmbytjes së standardit	Nuk përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Shkalla e përmbytjes së standardevë të fushës I	Nuk përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që DIFSH-i si një nga njësitë bazë që formojnë njësinë kryesore të FSHE-së, është përgjegjës për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile. Vumë re që janë rregulloret e departamentit, dhe rregullorja e programit. Në këtë rregullore janë të paraqitura struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit dhe elementët e tjerë të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore dhe miratohet edhe nga Senati Akademik i UMSH. Kjo rregullore i shtrin efektet e saj mbi të gjitha organet drejtuese akademike dhe administrative të UMSH, stafin akademik, studentët dhe stafin administrativ. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, bazuar në propozimet e njërive bazë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore. FSHE-ja së bashku me njësinë bazë, DIFSH-in përgjegjëse për programin, disponojnë rregulloren e nevojshme për funksionimin dhe organizimin e tij. Njësia përgjegjëse për programin e studimit bën të njohur të dhënat kryesore për programin në faqen zyrtare të institucionit për secilin nga profilet.</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/media/5ee7f6a71f024.pdf">https://www.umsh.edu.al/media/5ee7f6a71f024.pdf</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/media/5ee7f6a71f34c.pdf">https://www.umsh.edu.al/media/5ee7f6a71f34c.pdf</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/media/5ee7f6a71f5e5.pdf">https://www.umsh.edu.al/media/5ee7f6a71f5e5.pdf</a></p> <p>Kandidatëve që kërkojnë ndjekjen e programeve të studimeve të natyrës profesionale u ofrohet dokumentacioni që përfshin: rregulloren, planin mësimor, kriteret për pranimin, informacion mbi stafin akademik, kohëzgjatja dhe disa modalitete mbi procesin mësimor.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programit të studimit DP, TI&amp;AI; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH, pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/ lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që ky program zgjat 2 vite akademike, dhe ndahet në katër semestra, në përfundim të të cilave studenti fiton 120 kredite. Plani përmban 18 lëndë për secilin profil dhe ato zhvillohen të shtrira përgjithësisht në mënyrë uniforme në të dy vitet, nga 3 ose 5 lëndë në çdo semestër. Përveç lëndëve program ka edhe Praktikën profesionale dhe Projektin profesional/ Provimin. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë</p>

	<p>formuese që ofrohen në këtë program (si dhe kreditet për secilën prej tyre) mund të rishikohen nga departamenti DIFSH-it dhe “Dekanati”, duke i miratuar në Senatin Akademik. Format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore, detyrat projektet dhe provimet. Njësia bazë, me miratimin e Dekanit mund të përcaktojë forma të tjera të punës mësimore, vecanërisht në drejtim të kontrollit të dijeve të fituara.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI, Neni 13, 14, 15, 16, 17; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI, Evidenca 6. Strategjia e zhvillimit të programit DP, TI&amp;AI me profile, pyetjet gjatë vizitës në institucion. RVB)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që duke u bazuar në VKM-në, nr 41 datë 24.01.2018, në planin mësimor të programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, janë të shprehura qartë lëndët, modulet, praktikat dhe aktivitetet formuese të cilat janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Plani mësimor përcakton lëndët dhe praktikën mësimore të shprehura në orë dhe kredite. Plani përmban 18 lëndë për secilin profil dhe ato zhvillohen të shtrira përgjithësisht në mënyrë uniforme në të dy vitet, nga 5 lëndë në çdo semestër. Në vitin e parë dhe semestrin e parë të vitit të dytë të gjithë studentët marrin elemente teorike të përgjithshme që lidhen me grupin themelor të dijeve të domosdoshme. Në këtë aspekt ky program është i njëjtë për të tre profilet në vitin e parë dhe semestrin e parë të vitit të dytë. Në vitin e dytë ai ju ofron studenteve mekanizmat dhe dijet e nevojshme për realizimin praktik të detyrave sipas profileve të vecanta të përzgjedhura prej tyre. Përvec lëndëve programi ka edhe Praktikën profesionale dhe Projektin profesional/Provimin. GVJ konstatoi që njësia bazë, me miratimin e Dekanit mund të përcaktojë forma të tjera të punës mësimore, vecanërisht në drejtim të kontrollit të dijeve të fituara.</p> <p>(Aneksi 1. Tabelat permbledhese të programit të studimit: Plani mësimor i ndarë sipas tipit të Veprimtarive A-E; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI, Neni 13,14,15,16,17; pyetjet gjatë vizitës në institucion. RVB)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që syllabuset e secilës lëndë janë në përputhje me formatet e miratuara nga VKM-ja, nr. 41, Dt: 24.01.2018, pika 2.8. Syllabuset përmbajnë informacione të përgjithshme si emertimi i lëndës, emrin e titullarit dhe pedagogut që e zhvillon lëndën, ngarkesën në orë mësimore dhe kredite, tipologjinë e lëndës (kategorinë), vitin akademik dhe semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës, programin mësimor të cilit i përket, kodin e lëndës/modulit dhe adresën elektronike të titullarit të lëndës. Syllabuset me të gjithë elementët e mësimi që përmbajnë janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara. Më pas kemi përmbledhjen dhe</p>

	<p>rezultatet e të nxënit, objektivat, njohuritë dhe kompetencat. Konceptet themelore dhe më pas temat e lëndës japin orientim mbi të gjithë komponentët që zhvillohen. Gjithashtu jepet literatura, forma e kontrollit të dijeve dhe vërejtjet nga pedagogu i lëndës.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Aneks 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në hartimin e programit të studimit është marrë parasysh evoluimi i tregut të punës dhe dinamikat e zhvillimit në vend. Programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile synon nëpërmjet secilës lëndë, t'u japë studentëve terminologjinë e duhur profesionale që iu duhet në formimin e tyre profesional. Syllabuset me të gjithë elementët e mësimi që përmbajnë janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara. Më pas kemi përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat, njohuritë dhe kompetencat. Konceptet themelore dhe më pas temat e lëndës japin orientim mbi të gjithë komponentët që zhvillohen. Gjithashtu jepet literatura, forma e kontrollit të dijeve dhe vërejtjet nga pedagogu i lëndës. Ky program përmban lëndë të cilat kanë karakter ndërdisiplinor, dhe kjo i shëben formimit të gjithëanshëm të studentëve, zhvillimi i të cilave shprehet në rregulloren e programit të studimeve. Programi i studimit përveç lëndëve që përfshihen në disiplina të formimit karakterizues dhe që përbëjnë edhe drejtimin kryesor të programit, përmban edhe lëndë që bëjnë pjesë në disiplina të formimit të përgjithshëm, lëndë të karakterit integruar, lëndë plotësuese dhe lëndë me zgjedhje, të cilat i formojnë studentët, dhe u krijojnë mundësinë të orientohen drejt një kategorie më të gjërë profesionale dhe specialitetesh brenda fushës së teknologjisë së informacionit. Struktura dhe organizimi i programit është fleksibël dhe në përshtatje me punësimin.</p> <p>(Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 6. Strategjia e zhvillimit të programi DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në rregulloret e studimeve të UMSH-së, rregulloren e FSHE-së, rregulloren e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile si dhe në syllabuset e lëndëve janë përcaktuar qartë format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit teorik dhe praktik të lëndës. Këtu përfshihen aktivizimi në mësim, testimi i ndërmjetëm, detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vume re që në vitin e dytë programi ju ofron studentëve mekanizmat dhe dijet e nevojshme për realizimin praktik të detyrave sipas profileve të vecanta të</p>

	<p>përzgjedhura prej tyre. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Në varësi të lëndës pjesë e vlerësimit janë dhe projekte kursi ose detyra kursi. Ata mund të testohen me shkrim, me gojë, ose me kompjuter nëpërmjet metodave alternative. Gjate vizitës në institucion pamë laboratorët ku mund të zhvillohej kjo pjesë praktike. Përveç lëndëve programi ka edhe Praktikën profesionale dhe Projektin profesional/Provimin.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjate vizitës në institucion, RVB)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.2

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, ngarkesa mësimore organizohet në përputhje me aktet nënligjore që nxjerr ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. Senati i UMSH-së miraton programin e vitit akademik i cili zbatohet për të gjitha programet dhe veprimtaritë formuese. Ngarkesa në orë e studentit merr parasysh përcaktimet e VKM-së, nr 41, Dt. 24.01.2018 dhe akteve të tjera. Kjo ngarkesë përshkruhet në planin mësimor të këtij programi studimi. Për këtë program ngarkesa është mbi 3000 orë mësimore në total që përputhet me 120-kreditet e tij. Respektohet kërkesa ligjore që orët për punë të pavarur të jenë jo më pak se gjysma e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve vjetore. Në planin mësimor vihet re ndarja sipas semestrave e lëndëve. Gjithashtu janë shënuar edhe orët për leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikën. Oret e leksioneve, seminarëve dhe ushtrimeve janë dhënë si orë në auditor por edhe orë për punë të pavarur, së bashku me kreditet përkatëse.</p> <p>(Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Aneksi 1. Tabela me Planin mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese A-E; Aneksi 1. Tabela 13. Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit,</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, organizimi i lëndëve dhe praktikave është bazuar në LAL80/2015 si dhe në apo Direktivën</p>

<p>rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>2015/36 EC të Parlamentit European dhe Këshillit European. Programi i studimit ka një ekuilibër dijesh teorike dhe praktike. Ai jep elementë të kulturës së përgjithshme dhe zgjeron elementet e dijës profesionale. Integrimin sa më i mirë i studentëve në tregun e punës bëhet duke kombinuar pjesën teorike me anën praktike. Kjo mundëson rritjen e njohurive dhe kompetencave të nevojshme të studentëve. Vumë re që për të përshtatur sa më mirë programin me tregun e punës, UMSH-ja koordinon me FSHE-në dhe DIFSH-in vazhdimisht dhe vëzhgon ndryshimet në kërkesat për aftësi e njohuri të pozicioneve të punës në organizata/ biznese dhe i reflekton ndryshimet e nevojshme brenda lëndëve përkatëse. Gjithashtu në vazhdim në nivel programi mund të ketë riorganizime (nën 20% si dhe mbi 20% në ECTS) nqs vihet re që ka kërkesë për këtë nga tregu.</p> <p>(Evidenca 8. Studimi i tregut të punës; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, kemi 10 lëndë gjithsej në një vit akademik. Lëndët janë të shpërndara nga 5 për cdo semestër. Secila lëndë është e vlerësuar në kredite (ECTS) sipas tipit të veprimtarisë (A-E) dhe orë mësimore (leksionesh, seminaresh dhe praktika apo orë jashtë auditorit). Në këtë formë është mundësuar realizimi i objektivave të programit qoftë në formim të studentëve, por edhe në aftësimin profesional. Në semestrin e dytë të vitit të dytë janë edhe Praktika profesionale dhe projekti profesional/provimi. U vu re që DIFSH-i kryen në mënyrë periodike analiza dhe studime mbi rezultatet e pritshme të studentëve dhe realizimin e objektivave të programit.</p> <p>Literatura e përdorur gjatë procesit mësimor ka si qëllim të jetë një literaturë elitare. Për sa i përket teksteve me karakter teknik i kushtohet kujdes jo vetëm ri-botimeve të mëvonshme por edhe mundësive që këto të jenë të aksesueshme nga studentët.</p> <p>(Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që plani mësimor i programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, ka informacion për emërtimin e lëndëve, numrin e krediteve për secilën lëndë apo modul, semestri në të cilin zhvillohet lënda, orëve për leksione, seminare, ushtrime, praktike. Më pas në syllabuse jepen detyrimet e lëndës (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi), jepen komponentët e vlerësimit të</p>

	<p>studentit, periudha e kontrollit të dijeve, mënyra e vlerësimit të dijeve dhe mënyra e zhvillimit të provimit (me shkrim, me gojë, ose me shkrim dhe me gojë), ngarkesën mësimore, orët që kryhen në auditor, orët jashtë auditorit, frekuentimin, ndjekjen e programit dhe aftësimin praktik të studentëve. U vu re që personeli akademik ka eksperiencë të konsoliduar të praktikave. Disa prej programeve me anë të cilave zhvillohen praktikisht lëndët janë Notepad++, Multisim, Cisco Packet Tracer, Photoshop, PTV VISSIM etj. Në semestrin e dytë të vitit të dytë janë Praktika profesionale dhe projekti profesional/provimi.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve vumë re që cdo lëndë ka pjesë të formimit teorik me leksione, dhe pjesë praktike me ushtrime dhe seminare. Gjatë pyetjeve në institucion u konstatua që pjesa më e mirë e këtyre ushtrimeve dhe seminareve realizohet si punë praktike në auditor, pra raporti është përafërsish i ndarë në 50 me 50.</p> <p>Gjithashtu praktika në fund ka 6 kredite, 6 kredite edhe projekti profesional, dhe së bashku me praktikën gjatë ushtrimeve dhe seminareve e kalon 25% që i dedikohet aftësimit praktik dhe punëve konkrete.</p> <p>(Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që ndarja sipas veprimtarive formuese, në programin e studimit DP, TI&amp;AI me 3 (tre) profile është bërë sipas akteve ligjore në fuqi. Ky organizim mundëson për programin arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Në këtë program studimi, ka një rëndësi të vecantë pjesa që përfaqëson disiplina e formimit karakterizues që vëmë re nga plani mësimor që shkon në 52%, me 62 Kredite. Gjithashtu me pas vijën lëndët bazë dhe lëndët ndërdisiplinore secila me 15% të totalit të krediteve, dmth me nga 18 Kredite secila veprimtari. Më pas janë lëndët plotësuese me 13%, ose 16 Kredite, dhe detyrime përmbyllesë me 6 Kredite ose 5% të totalit të krediteve. Raporti midis veprimtarive me karakter teorik e atyre me karakter praktik, mundëson një formim më të mirë profesional të studentëve. Ky formim ju mundëson punësimin në pozicione ku kërkohen njohuri të fushave të programimit, elektronikës, digjitalizimit etj., edhe pa pasur një formim të thelluar. U vu re edhe gjatë takimeve në institucion që kjo natyrë informacioni që ju ofrohet studentëve nga ky program studimi, ka lehtësuar punësimin në profile sipas studimit të kryer. Nga analizat vjetore e periodike të punës mësimore të bëra në departament</p>

	<p>rezulton se programi ka arritur të objektivave formuese të tij. GVJ vuri re gjatë pyetjeve në institucion që në ndryshime me tej në hartimin e programit të studimit do të merret parasysh evoluimi i tregut të punës, sic është vepruar edhe në fillim.</p> <p>(Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Aneksi 1. Tabela me Planin mësimor të ndarë sipas Veprimtarive Formuese A-E; Evidenca 8. Studimi i tregut të punës; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi II.3

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe vlerësimi në kredite bëhet sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai është i organizuar në lëndë dhe module ku vlerësohen me një numër të caktuar kreditesh sipas tipit të veprimtarisë (A-E) në përputhje me VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018. Programi i studimit me natyrë profesionale në Teknologji Informatike dhe Aplikime Informatike me profile realizohet me ndjekje të mësimin me kohë të plotë, kohëzgjatja është 2 (dy) vite akademike (katër semestra), për secilin semestër grumbullohen përkatësisht nga 30 kredite, në përfundim të të cilëve studenti fiton 120 kredite (ECTS). Vume re që plani mësimor i programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, reflekton në mënyrë të detajuar një sërë informacionesh për emërtimin e lëndëve, numrin e krediteve për secilën lëndë, semestri në të cilin zhvillohet lënda, orëve për leksione, seminare, ushtrime, praktike. Lëndët janë të shpërndara nga 5 për cdo semestër. Secila lëndë është e vlerësuar në kredite (ECTS) sipas tipit të veprimtarisë (A-E) dhe orë mësimore (leksionesh, seminare, ushtrime, praktike apo orë si punë e pavarur). (Evidenca 2. Rregullore Programit DP, TI&amp;AI; Evidenca 7. Plan mësimor i Programit DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/ të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Përmbajtja e planit mësimor ka në thelb përcjelljen e njohurive sa më praktike në kuadrin e një programi studimi profesional. GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përmbajtja e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, krijon një bazë solide për vijueshmërinë e mëtejshme të punësimit në fushat respektive të studimit. Lëndët e programit</p>


	<p>mundësojnë marrjen e njohurive dhe kompetencave të nevojshme për kërkesën e tregut të punës me teknikë të fushës e pajisjeve elektronike, specialistë të rrjeteve të kompjuterave apo teknik softesh dhe digjitalizimi, dmth sipas profileve. Programi përmban të gjithë elementët e nevojshëm që studentët e diplomuar ti përshtaten sa më mirë tregut të punës. Në industrinë e tregut ky lloj formimi që del nga ky program është i nevojshëm për kompanitë në fushën e IT për arsye se çdo lloj aktiviteti tashmë ka kontakte të pashmangshme me rrjetin dhe software-t apo qoftë dhe elektronikën. U vu re edhe gjatë takimeve në institucion që kjo natyrë informacioni që ju ofrohet studentëve nga ky program studimi, ka lehtësuar punësimin në profile sipas studimit të kryer. (Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në aktet rregullatore të UMSH-së, në rregulloren e institucionit, të fakultetit, dhe programit të studimit, është shprehur profili i programit dhe njohuritë që ai jep. Studentët njihen me të rejtat më të fundit në fushën e teknologjisë se informacionit, inovacionit, dhe aplikimeve informatike sipas profileve perkatëse. Kjo realizohet nga përditësimi periodik i përmbajtjes së lëndëve, bazuar në literaturë bashkëkohore. Vumë re që në syllabuset e lëndëve tematikat janë bashkëkohore. Përmes metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies kërkohet nga studentët implementimi i trajtimit teorik në aspektin praktik. Çdo vit akademik syllabuset rishikohen dhe përmirësohen në përputhje të plotë me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të miratuara nga UMSH-ja si dhe kërkesat e tregut të punës. Përditësimi i metodave mësimdhënëse dhe dobishmëria praktike e tyre plotësohen me literaturën e nevojshme dhe me materialet didaktike që çdo pedagog depoziton në bibliotekën e institucionit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ bëri vizitë edhe në bibliotekë, ku pati mundësi të shikonte të depozituara materiale të përgatitura nga pedagogët për lëndë të ndryshme, dhe ku studenti kishte mundësi aksesit në to për të marrë materialet. Secili nga pedagogët shpjegoi gjatë takimit që ndjek metoda të ndryshme mësimdhënie në mënyrë që të përthithet sa më mirë dija dhe të kenë mundësi ta aplikojnë atë edhe në formë praktike. Po kështu pjesa e vlerësimit shënohet në syllabuse dhe rishikohet çdo vit si formë dhe është e kombinuar me aktivizim në seminare/ provim të ndërmjetëm/ detyra/ projekte kursi dhe provimin përfundimtar. GVJ vuri re që mënyra e vlerësimit është semestrale dhe realizohet nëpërmjet formave tradicionale dhe alternative të vlerësimit që reflektojnë stilet e ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke e bërë vlerësimin pjesë integrale të procesit mësimor. (Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; pyetjet gjatë vizitës në</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundësojnë përfundimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>institucion, RVB)</p> <p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përmbajtja e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, mundëson zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të avancuara në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Aplikimeve Kompjuterike të cilat garantojnë zgjidhjen e problemeve komplekse në funksion të profesionit. Pedagogët zhvillojnë tek studentët metoda të avancuara të cilat ata i aplikojnë në zgjidhjen e problematikave. Përmes përgatitjes së studentëve realizohet synimi kryesor i programit që ndërthur njohuritë teorike dhe aplikimin praktik të lidhura të dyja direkt me kërkesën e tregut të punës. Metoda interaktive përgjatë seminareve dhe të shembujve të ndryshëm aplikohen tek studentët të cilëve më pas u kërkohen zgjidhje dhe aplikime praktike apo ideve të krijuara për të adaptuar një projekt të caktuar me temë në varësi të profilit përkatës. Kjo mënyrë ka synim pajisjen e studentëve me dijet e nevojshme profesionale dhe aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e teknologjisë, elektronikës dhe jo vetëm. Programi përmban të gjithë elementët e nevojshëm që studentët e diplomuar ti përshtaten sa me mire tregut të punës. Në industrinë e tregut ky lloj formimi që del nga ky program është i nevojshëm për kompanitë në fushën e IT për arsye se çdo lloj aktiviteti tashmë ka kontakte të pashmangshme me rrjetin dhe software-t apo qoftë dhe elektronikën. Ata nxiten përmes pjesës praktike dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies përfshirë këtu edhe detyrat e kursit, projektet, etj për të pasur mendim kritik dhe për ti ilustruar në praktikë njohuritë e marra.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/ përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që DIFSH-i, përgjegjës i programit DP, TI&amp;AI me profile, kryejnë në mënyrë periodike konsultime dhe marrin parasysh propozimet nga biznesi dhe kompanitë private mbi ndryshimet e tregut të punës. Këto propozime shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së programit. Ata ftojnë vazhdimisht ekspertë të fushës në ambientet e UMSH-së për të dhënë sugjerimet e tyre apo të reja të transformimeve të tregut të punës si dhe konsultim që vijnë nga organizata të ndryshme (AKSHI-i, konsulencia, biznese me profil teknologjik, etj). Gjithashtu bashkëpunimi gjatë praktikave dhe intershipeve garanton një mundësi për studentët që të shihen direkt nga kompanitë me synim me pas punësimin. Tryezat e rrumbullakëta realizojnë një bashkëpunim shumë të ngushtë dhe diskutim të programit dhe përshtatjes së tij, duke marrë feedback edhe nga studentët edhe nga kompanitë dhe bizneset.</p> <p>(Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Aneksi I Tabela 5. Lista e marrëveshjeve midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera; <a href="https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe">https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe</a>); pyetjet</p>



	gjate vizites ne institucion, RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UMSH-ja është e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve. Kjo lidhet me shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesëmarrje në konferenca e seminare kombëtare ose rajonale, si dhe përfshirjen në studime. Me angazhimin e strukturave dhe instrumentave që disponon, UMSH-ja nxit rritjen e nivelit shkencor individual të pedagogëve dhe përcjelljen e njohurive shkencore, përvojave, përdorimin e metodave të reja në aktivitetin e tyre mësimdhënës. UMSH tregon një kujdes të veçantë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në aktivitetet e tjera ku personeli angazhohet. Institucioni organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit, në drejtime si: metodika e mësimdhënies, inovacionet në sektorë të ndryshëm, njohja e kuadrit rregullator të institucionit brenda kornizës së arsimit të lartë. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të rinj, duke si në aspektet metodike edhe të organizimit të mësimin, aftësimi në programe kompjuterike dhe platformave online, për procesin e diplomimit etj.</p> <p>Përveç këtij mekanizmi, UMSH ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBCZHK). Kjo njësi përbëhet nga 7 anëtarë që kanë mandat 3 vjeçar dhe aprovohen nga senati. Neni 10 i rregullores së NJSBCZHK përcakton që njësia e vlerësimit të brendshëm të cilësisë bashkëpunon dhe ka mbështetjen e të gjitha organeve drejtuese për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Neni 12 i rregullores së NJSBCZHK përcakton se anketimet për vlerësimin e performancës së pedagogëve bëhen përpara provimit përfundimtar në fund të çdo semestri dhe në kohë të përshtatshme për të lehtësuar vlerësimin objektiv të studentëve. Neni 13 i rregullores së NJSBCZHK shpjegon që të gjitha anketimet përpunohen dhe shoqërohen me një raport të hollësishëm i cili është në dispozicion të zyrës së burimeve njerëzore, ashtu edhe rektoratit. Në rast problematikash zhvillohen diskutime me pedagogun përkates për zgjidhjen dhe përmirësimin e tyre.</p> <p>(Evidenca 19. Program trajnimi dhe kualifikimi 2020-2021; Evidenca 11. Rregullore NJSBCZHK; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/ eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që procesi i mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, realizohet në bazë grupi leksioni dhe seminari. Format e mësimdhënies të përdorura nga UMSH në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile janë: leksionet, seminarët, detyra kursit/ projekte, praktika profesionale dhe orët e konsultimit. GVJ vuri re që aplikohet zhvillimi interaktiv i leksioneve duke u përpjekur të tërhiqet vëmendja e studentëve me pyetje të ndryshme, në mënyrë që leksioni të bëhet sa më tërheqës dhe i kuptueshëm për ta. Trajtimi praktik konsistonte në përgatitjen e detyrave të kursit ku janë angazhuar sipas profileve psh. Ndërtimin e një faqe web-i, realizimin e qarqeve elektronikë me anë të simulatorit Multisim etj. Në përputhje me karakterin aplikativ të programit dhe lëndëve që ai përfshin, në orët në auditor synohet trajtimi i situatave konkrete dhe sjellja e shembujve nga bizneset shqiptare. GVJ gjatë vizitës dhe pyetjeve konstatoi që disa leksionesh të hapura dhe aktivitete janë kryer me të ftuar nga biznesi dhe institucione shtetërore, si TCT-ja, Lufthansa, INSTAT-i, etj. Në seminare trajtoheshin raste studimi, ushtrime, sipas lëndëve, dhe zinte vend edhe shpjegimi nga pedagogu i çështjeve për të cilat studentët kishin paqartësi. Në seminare pedagogët bënë vlerësimin e përgjithshëm dhe individual të dijeve të studentëve. Kjo ndikonte në vlerësimin përfundimtar të studentëve dhe po ashtu ndihmonte pedagogun të kuptonte se ku qëndronin vështirësitë për studentët.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH; Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; pyetjet gjate vizites ne institucion, RVB; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, personeli akademik përdor metoda mësimdhënie dhe mësimnxënie për t'ju përgjigjur diversitetit si dhe nevojave të studentëve. Personeli akademik merr parasysh natyrën specifike të programit të studimit dhe ka përdorur metoda të larmishme të mësimdhënies. Nisur nga natyra e programit profesional të studimit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar punës në laborator apo si dhe aspektit praktik duke ndërthurur në vlerësim projekte apo detyra kursi. Tjetër mund të përmendim metodat vizuale apo teste me shkrim ose me alternativa të përshtatshme për studentët që mund të përthithin ose të kryejnë provimet lehtësisht. Këto mundësi përcaktohen në rregulloren e institucionit si dhe janë të shprehura edhe në syllabuset e programit. Gjithashtu, me studentët që paraqesin kërkesa për vështirësitë që kanë në përvetësimin e koncepteve themelore të lëndëve organizoheshin konsultime nga pedagogët sipas profileve duke caktuar ditë dhe orare të përcaktuara., UMSH duke u bazuar te aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, respekton diversitetin e studentëve me aftësi ndryshe duke</p>

	<p>krijuar korniza institucionale adekuate për integrimin e tyre në procesin mësimor. Gjatë pyetjeve vumë re që në periudhën e pandemisë, kishte rritje përdorimi i materialeve në formë elektronike. Vëmë re në tabelën 17, që kemi përdorim të platformave online me G-SUITE, bibliotekës online dixhitale, etj.</p> <p>(Evidenca 26. Relacion i verifikimit të godinës 2021; Aneksi 1. Tabela 16. Mjediset e fakultetit/ Njësive bazë; Evidenca 15. Rregullore për studentët me aftësi ndryshe; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB; Tabela 17. Të dhëna të plota për platformat online/ struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ biblioteka online etj)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, ka kompetencat e duhura për të realizuar me sukses këtë program.</p> <p>Nga tabela 6 me stafin akademik për programin e studimit, vëmë re që <b>në vitin akademik 2021-2022 në programin e studimit Diplomë Profesionale në TIAI me profile janë në total 15 pedagogë nga të cilët, 13/PAE dhe 2/PAK. PAE jane 1 me titull Prof. Asoc., 2 Dr., dhe 10 MSc. Ndërsa PAK janë 2 Msc.</b></p> <p>Ndërsa në vitin akademik 2020-2021 në programin e studimit Diplomë Profesionale në TIAI me profile janë në total 9 pedagogë nga të cilët, <b>9/PAE dhe 0/PAK.</b> PAE janë 1 me titullin Prof.Asoc, 1 Dr., dhe 7 MSc. Ndërsa PAK nuk ka.</p> <p>Duke parë Tabelen 4 lidhur me ngarkesën mësimore vëmë re që orët mësimore janë 3240 në total nga të cilat 3060 ore janë realizuar nga PAE dhe 180 orë janë realizuar nga PAK. <b>Stafi akademik PAE mbulon 94% të orëve, duke plotësuar dhe kaluar ngarkesën e kërkuar nga ligji që është 70 % e totalit të orëve.</b></p> <p>Nga tabelat shihet që stafi është kompetent, me tituj dhe grada. Sipas procedurës së rekrutimit të stafit, fokusi është të përputhja e kërkesave me aftësitë profesionale të kandidatit. Fokusi i pedagogëve përqendrohet në punët laboratorike që punohen në sallat e praktikës duke përdorur programe që i vijnë në ndihmë si Notepad++, Multisim, Cisco Packet Tracer, Photoshop etj. Punësimi i këtij personeli është bërë në përputhje me LAL 80/2018: Kreu VI, Neni 64, si dhe duke u bazuar në rregulloren e organizimit të UMSH. Institucioni kujdeset për përputhjen sa më të plotë të përshkrimit të vendit të punës me aftësitë individuale të personelit të angazhuar. Në mësimdhënie, ata përdorin metoda audio dhe vizuale, dhe simulacione të ndryshme sipas temave dhe profilit të modulit. Stafi akademik përdor metodologji efektive të mësimdhënies bazuar në TIK, me anë të kompjuterave në klasë. Gjithashtu kompjuterat e vendosur në laboratorë përmbajnë të gjithë programet dhe paketat e nevojshme sipas lëndëve specifike të</p>




	<p>këtij programi studimi. Vumë re gjatë vizitës në institucion që klasat, laboratorët janë të pajisura me mjetet, programet e nevojshme.</p> <p>(Aneksi 1. Tabelat përmbledhese të programit të studimit, Tabela 6; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH; Evidenca 25. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit të stafit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që një nga prioritetet e UMSH-së është vlerësimi i aftësive të personelit si dhe ngritja profesionale e stafit akademik dhe atij ndihmës. Institucioni i mundëson personelit trajnimin sipas fushave të përcaktuara dhe profilit nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. (<a href="https://www.umsh.edu.al/d/180/trajnohet-stafi-i-umsh">https://www.umsh.edu.al/d/180/trajnohet-stafi-i-umsh</a>)</p> <p>Vumë re si GVJ që UMSH ka në filozofinë e tij të mësimdhënies dhe mësimnxënies kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo realizohet me anë të formave të ndryshme të bazuara mbi procedurat dhe udhëzimet përkatëse institucionale dhe hierarkike. Një nga format e përdorura është përmes anketimit për vlerësimin e pedagogut të lëndës, i cili është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor vumë re që zhvillohet para fillimit të provimit final në fund të çdo semestri. Rezultatet e dala nga pyetësorët përdoren si një kontribut për përmirësimin e mëtejshme.</p> <p>(Evidenca 21. Manual i NJSBCZHK; Evidenca 23. Procedura e punës me fokus grupet; Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti; Evidenca 19: Tabela për trajnimin e stafit; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile zhvillohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. UMSH ofron kushte teknike dhe higjeno-sanitare shumë të mira. Procesi mësimor me pjesën teorike dhe praktike kryhet në ambiente të përshtatshme dhe me cilësi. Sallat ku zhvillohet procesi mësimor dhe praktika janë objekte të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare. Vumë re që institucioni garanton</p>

	<p>mjedisi pune të sigurtë. Punët praktike sigurohen nga 3(tre) salla të pajisura me mjetet e nevojshme në shërbim të realizimit të laboratoreve. Auditorët dhe ambientet e përbashkëta janë me sistem qëndror ngrohje/ftohje; për të evituar zhurmat, sallat dhe zyrat janë të ndara me dopio-gips, ndërsa për të evituar zhurmat nga jashtë, dritaret janë me dopio-xham. UMSH-ja plotëson kushtet e sipërfaqes dhe vëllimit të shfrytëzueshëm për student, plotëson normativat e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën dhe përmbush kërkesat për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. Ka furnizim të vazhdueshëm me ujë dhe energji elektrike dhe plotëson normativat higjieno-sanitare. Mirëmbajtja realizohet nga personeli i angazhuar për këtë qëllim.</p> <p>Vume re qe klasat kishin video-projektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless. Për të mundësuar një metodologji më efektive të mësimdhënies bazuar në TIK, kompjuterat në klasë dhe kompjuterat e vendosur në laboratorë përmbajnë të gjitha programet dhe paketat e nevojshme për lëndët specifike të këtij programi studimi.</p> <p>(Evidenca 26. Relacion i verifikimit të godinës 2021; Aneksi I. Tabela 16. Mjediset e Fakultetit/ Njësive Bazë; pyetjet gjatë vizitës në institucion, RVB)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik dhe studentët e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile shfrytëzojnë ambiente funksionale, laboratorike dhe infrastrukturë moderne të UMSH-së. Vumë re që klasat kishin video-projektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless, kompjutera, sistem zëri/ fonie. Ato mundësojnë organizimin e video- konferencave, lidhjeve të ndryshme dhe diskutimeve on-line. Mirëmbajtja dhe përditësimi i pajisjeve kompjuterike dhe programeve të instaluar sigurohet nga Zyra IT-së. Laboratorët e informatikës, elektronikës, biblioteka, laborator i gjuhëve të huaja, janë të pajisur me kompjutera të gjeneratave të fundit. Vumë re që në këto kompjutera janë instaluar si programet bazë Windows 7, paketa Microsoft Office, edhe programe specifike, programe aplikative të informatikës, elektronikës, digjitalizimit etj. (Notepad++, Multisim, Dev-C++, SPSS etj), gjuhës së huaj (EXCELLER, T-Translator, GINGER), etj.</p> <p>(Evidenca 26. Relacion i verifikimit të godinës 2021; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, UMSH-ja siguron literaturën bazë të detyrueshme dhe literaturën e rekomanduar. Studentëve u ofrohet edhe literaturë ndihmëse nga botimet e fundit në fushat përkatëse të vetë pedagogëve mësimdhënës.</p>



<p>programin e studimit.</p>	<p>Informacioni i detajuar mbi literaturën e nevojshme mbështetëse iu bëhet i ditur studentëve çdo fillim viti akademik nga pedagogu përgjegjës për lëndën. Ky informacion evidentohet në syllabuset dhe është lehtësisht i konsultueshëm në bibliotekën e institucionit në formë fizike dhe elektronike. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi që literatura gjendet në bibliotekën e UMSH-së në versionin fizik, me numër të konsiderueshëm titujsh dhe kopjesh, dhe në formë elektronike në formatin “Fondi i literaturës elektronike të UMSH-së”, të përdorshme nga i gjithë personeli akademik dhe studentët. Biblioteka digjitale e UMSH-së ofron një masë të konsiderueshme literature në gjuhë të huaj dhe shqip. Kjo literature është e aksesueshme nga personeli akademik dhe studentët dhe është në dispozicion të studimeve më të thelluara nga ana e studentëve sipas fushave të programit dhe sipas profilit të tyre. Koleksioni i bibliotekës pasurohej me blerje të reja. Librat e blerë zgjidhen sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Fondi i bibliotekës vumë re që përditësohet çdo vit. Kërkesat gjenerohen nga njësi bazë dhe miratohen sipas hierarkisë deri në plotësimin e tyre.</p> <p><a href="http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php">http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php</a></p> <p>(Evidenca 16. Kërkesë për libra DIFSH; Aneksi 1. Tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në zbatim të planit strategjik të zhvillimit ku fokusi është në rritjen e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies, UMSH ka vënë në funksionim një sistem informacioni të avancuar dhe të përshtatshëm për aktivitetin mësimor e shkencor, për stafin dhe studentët. Vumë re që sistemi, përmes faqes zyrtare të UMSH, ofron akses online në të gjithë literaturën e vënë në dispozicion nga pedagogët në funksion të programit mësimor, nëpërmjet portaleve të tyre. Studentë apo persona të tjerë të interesuar kanë mundësi në vazhdimësi të konsultojnë lehtësisht në website materiale në formë elektronike. Biblioteka digjitale e UMSH është në përdorim të stafit dhe studentëve. Ajo u mundëson atyre akses në literaturë mbështetëse për procesin mësimor dhe për punën kërkimore shkencore. Vumë re që mësimi online me platformën G-Suite dhe Zoom ka rezultuar praktik dhe efikas në kushtet e jashtëzakonshme sanitare gjatë Covid-it. Kjo eksperiencë digjitalizimi e mësimdhënies dhe mësimnxënies shërben si një praktikë efektive dhe bën përshtatjen me sfidat e së ardhmes.</p> <p>(Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH; Aneksi 1. Tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line/</p>


	Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UMSH ka kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve. Për zhvillimin e procesit mësimor, departamenti ka në dispozicion disa laboratorë kompjuterike. Punët e laboratorit dhe mësimet praktike zhvillohet në ambiente që kanë programet përkatëse, të duhura, me ndihmën e pajisjeve, simulatorëve dhe softveve sipas profilit përkatës. Punët laboratorike realizohen sipas lëndëve duke përdorur infrastrukturën e krijuar. Vumë re që kishte një mjedis komod dhe kishte lehtësi në përdorimin e tij nga studentët. Kjo e bënte atë të ishte i shfrytëzueshëm nga studentët. ( <a href="https://www.umsh.edu.al/media/625827e15be4d.pdf">https://www.umsh.edu.al/media/625827e15be4d.pdf</a> ) (Evidenca 26. Relacion i verifikimit të godinës 2021; pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB)
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UMSH ka vënë në funksionim një sistem informacioni të avancuar dhe të përshtatshëm për aktivitetin mësimor e shkencor, për stafin dhe studentët. Institucioni zbaton planin strategjik të zhvillimit dhe synon rritjen e cilësive së mësimdhënies e mësimnxënies. Sistemi i informacionit, përmes faqes zyrtare të UMSH-së, ofron akses online në të gjithë literaturën e vënë në dispozicion nga pedagogët në funksion të programit mësimor, nëpërmjet portaleve të tyre. Të gjithë studentët apo të tjerë të interesuar, kanë mundësi të konsultojnë në website materiale në formë elektronike. Bibliotekat online në përdorim të stafit dhe studentëve ju japin atyre akses në një masë të madhe literaturë mbështetëse për procesin mësimor dhe atë kërkimor shkencor. Mjetet e komunikimit të brendshëm garantojnë shpërndarjen e informacioneve për veprimtarinë funksionale të institucionit. Materialet mund të shfrytëzohen në çdo kohë. Mësimi online me platformën G-suite vumë re që ka rezultuar praktik dhe efikas në kushtet e vështira sanitare që kalon vendi dhe bota. Për të ardhur në ndihmë procesit mësimor, kombinohet forma në auditor me formën jashtë tij. Vumë re që përmes këtij sistemi, çdo pedagog u dërgon materialet e leksioneve, studentët dërgojnë projektet e tyre ose detyrat dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndët përkatëse.  (Pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB; Evidenca 4. Plan i Strategjik i Zhvillimit të UMSH; Aneksi 1. Tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që UMSH, bazuar edhe në LAL 80/2015: Kreu X, Neni 103, për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe në Udhëzimin nr 27. Dt. 29.12.2017: Pika 3 (strukturat ndihmëse akademike), ka ngritur NJSBCZHK-në e cila vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të njësisë kryesore dhe bazë për programet e studimit. Gjithashtu përcaktonte, orientonte dhe monitoronte ose kontrollonte gjithë përgjegjësitë me cilësinë në të gjitha hallkat. Në koordinim edhe me DIFSH-in si dhe FSHE-në nëpërmjet metodave direkte dhe të tërthorta (përdorimi i pyetësorit për studentet; studimet gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve), në përputhje edhe me Kodin e Cilësisë, ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies për programin e studimit. Kjo bëhet në koordinim të plotë midis departamentit, fakultetit dhe NJSBCZHK-në. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Synimi i kësaj njësie në plan afatgjatë ishte i lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të kulturës së cilësisë në UMSH.</p> <p>(Pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB; Evidenca 5. Rregullore FSHE; Evidenca 21. Manual i NJSBCZHK)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personi përgjegjës për cilësinë e mësimin në nivel fakulteti në FSHE është Dekani. Ai ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në FSHE, ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e kurrikulave, planeve dhe programeve mësimore, strukturës së vitit akademik etj, për ciklin e parë dhe të dytë në studimeve në të gjitha departamentet e FSHE-së. Vumë re që DIFSH-i, departamenti përgjegjës për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, në bashkëpunim me FSHE-në dhe me NJSBCZHK-në, kanë kryer monitorim dhe vlerësimin periodik. Kjo ndihmon që personeli akademik dhe ndihmës akademik të rrisë cilësinë në mësimdhënie. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve cilësorë</p>

	<p>përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e UMSH. Në departament janë punësuar rregullisht pedagogë nëpërmjet të shpalljes publike të vendeve të lira të punës. Departamenti organizon dite me informacione shkencore dhe leksione të hapura. Ky organizim ndihmon që stafi i ri të ndjeje orë leksionesh nga stafi më me përvojë dhe gjithashtu ben që stafi i ri të asistohet gjatë orëve të hapura nga përfaqësues të departamentit dhe fakultetit.</p> <p>Vumë re që ndikim të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit të këshillit studentor si edhe pyetësorët semestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Kjo bëhet në koordinim midis departamentit, fakultetit dhe NJSBCZHK-së. Të dhënat nga pyetësorët, përpunohen dhe shfrytëzohen rezultatet në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës dhe për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>(Pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB; Evidenca 5. Rregullore FSHE; Evidenca 9. Rregullore DIFSH; Evidenca 21. Manual i NJSBCZHK)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që në kontratën e punësimit midis UMSH-së dhe personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit, janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet individuale të secilit pedagog. UMSH ofron mundësinë e kualifikimit të mëtejshëm të personelit si nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve brenda vendit ashtu edhe nëpërmjet kërkimeve jashtë vendit. Vumë re që kualifikimi jashtë vendit realizohej nëpërmjet studimeve të ndryshme afatshkurtra ose afatgjata, si dhe nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve. Personeli akademik dhe ai ndihmës mban përgjegjësi për realizimin e programit të lëndës. Vume re si GVJ që personeli akademik dhe ndihmës akademik, në përputhje me objektivat e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, angazhohet direkt dhe indirekt në zbatimin e programit dhe realizimin e planit mësimor, në hartimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, duke synuar harmonizimin e këtyre aktiviteteve, në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Personeli ndihmës-mësimor shkencor dhe ai administrativ janë në mbështetje dhe kryejnë veprimtari në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor të institucionit. Rol të veçantë luajnë personeli i informatikës, bibliotekës dhe sekretaria. Departamenti mban kontakte të vazhdueshme me kompani të ndryshme që operojnë në Shqipëri për vlerësuar edhe nevojat e tyre si dhe përshtatjen</p>

	<p>e këtyre nevojave në procesin e mësimdhënies. (Pyetjet gjatë vizitës në institucion; RVB; Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 25. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit të stafit)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që me angazhimin e strukturave dhe instrumentave që disponon, UMSH nxit rritjen e nivelit shkencor individual të pedagogëve dhe përcjelljen e njohurive shkencore, përvojave, përdorimin e metodave të reja në aktivitetin e tyre mësimdhënës. Përvetësimi i metodave më të avancuara të studimit dhe ndërkombëtarizimi i punës shkencore duke e orientuar punën shkencore individuale dhe të grupeve brenda departamenteve drejt projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare shihet si një mënyrë e mirë që mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Mënyra tradicionale e mësimdhënies gjatë kohës të studimit shoqërohen edhe me forma të tjera, si ushtrimet praktike, detyra kursi, punimet e pavarura, temat përshkrimore. Në disa nga lëndët pedagogët përdorin materiale audiovizuale gjatë orës së mësimin për t'ju paraqitur studentëve situata reale, të cilat i diskutojnë me studentët duke nxitur analizën kritike dhe pjesëmarrjen aktive. Në programin e studimit DP, TI&amp;AI, UMSH-ja vume re qe po ofron aktualisht trajnime dhe certifikime me certifikata ndërkombëtare si Cisco: It Essential, Python, C/C++, Cyber Security për realizimin sa më të mirë të tij, aktualisht pranë ambienteve ku zhvillohen leksionet dhe seminarët e lëndëve të programit.</p> <p><a href="http://www.netacad.com">www.netacad.com</a></p> <p>(Pyetjet dhe konstatimet gjatë vizitës në institucion, RVB; Aneksi 1,5 lista e marrëveshjeve; marrëveshjet e UMSH)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që gjatë këtyre dy viteve të fundit akademike, është bërë një përpjekje e madhe për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies. Efektshmëria e kësaj përpjekje të personelit akademik dhe ndihmës akademik reflektohet në shumë drejtime si në drejtim të futjes së teknologjisë informacionit në mësimdhënie, në mënyrat e reja të zhvillimit të mësimin duke i bërë ato interaktive, kombinimi i trajtimeve teorike të programit mësimor me aspekte praktike në fushën e teknologjisë së informacionit etj, pasqyrojnë disa nga rezultatet e kësaj përpjekje. Vumë re që nga efektet e pandemisë u bë e mundur aplikimin e metodave virtuale të mësimdhënies gjatë vitit të kaluar. Stafit akademik dhe ndihmës akademik testojnë metoda të reja të mësimdhënies, duke analizuar efektet e tyre dhe raportojnë informacionin tek departamenti mbi gjetjet. Procesi i mësimdhënies është i lidhur ngushtë me nivelin e</p>



	<p>studentëve që vijnë nga cikli i parë i studimeve dhe ndryshimet në kurrikulat e tyre universitare. Në këtë rast monitorohej performanca e tyre akademike. Përveç aplikimit të metodave inovative në mësimdhënie, personeli akademik dhe ndihmës raportojnë tek përgjegjësit e departamentit lidhur me rezultatet e punës.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP TI&amp;AI; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH; Pyetjet dhe konstatimet gjate vizites ne institucion, RVB)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, DIFSH është përgjegjës për programin e studimit DP, me profile TI&amp;AI, që e ka të përcaktuara në rregullore të programit, mënyrën e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Në format e kontrollit të dijeve me shkrim përdoret vlerësimi me pikë, të cilat përkthehen në nota. Kontrolli i dijes mund të bëhet me shkrim ose i kombinuar. Tezat e provimit të lëndëve hartohen nga titullaret e lëndëve. Më pas bëhet miratimi nga njësia përgjegjëse.</p> <p>Po kështu studenti mund të futet në provim kur ka përmbushur detyrimet akademike që lidhen me atë lëndë. Procesverbali i detyrimeve plotësohet nga pedagogët.</p> <p>Më pas procesverbali i provimit firmoset nga anëtarët e komisionit, sekretaria mësimore dhe dekani.</p> <p>Komponentët dhe mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI, Neni 17,18,19,20; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit.)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e studimeve të UMSH-së, Rregulloren e FSHE-së, rregulloren e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile si dhe në syllabuset e lëndëve apo moduleve janë përcaktuar qartë format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/ modulit si aktivizimi në mësim, si testimi i ndërmjetëm/ detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Pjesë e vlerësimit janë dhe projekte ose detyra kursi në varësi të</p>


	<p>modulit. Ata mund të testohen me shkrim, me gojë, apo me kompjuter nëpërmjet testeve me alternativë.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Aneksi/2. Syllabuset e lëndëve të programit, pyetjet gjate vizites ne institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës / modulit.</p>	<p>Në takim me studentet, konstatojmë se studentët njihen që në fillim të ciklit të studimeve me programin mësimor nëpërmjet prezantimit të syllabuseve që bëhen nga pedagogët e lëndëve të programit. Në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, pedagogu titullar i lëndës apo modulit para fillimit të çdo semestri informon studentët për tematikat që do të zhvillohen, qëllimin si dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore që përfitojne studentët.</p> <p>(Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit, Takim me studentët, e GVJ ne institucion)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive për studentët e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile realizohet gjatë gjithë vitit akademik me pikë dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar me notë. Proçedura e vlerësimit është e përcaktuar qartë në rregulloren e UMSH, rregulloren e programit të studimit. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: aktivizimi gjatë zhvillimit të modulit, testimi i ndërmjetëm/ detyrat e kontrollit dhe provimi final. Pedagogu i lëndës/ modulit i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provimin final si dhe nivelin e pikëve të fituara nga vlerësimi i vazhduar në orën e fundit të mësimit. Provimi final, sipas përcaktimeve në syllabus, organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve dhe i nënshtrohet provimit final. Përcaktimet e Rregulloreve të studimeve, në nivel Universiteti, fakulteti dhe departamenti, garantojnë një vlerësim të drejtë të studentëve, transparent dhe bazuar mbi meritën e secilit student. Studenti paraqitet ne provim me dokumentin e identifikimit personal. Per te ruajtur transparencen dhe sigurine e studenteve mbasi fillon provimi nuk lejohet qe ne salle te hyjne persona te jashtem, pervec dekanit dhe rektorit per kontroll.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 5. Rregullore FSHE; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Evidenca 3. Rregullore e organizimit te UMSH, nenet 61-65; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënimit për të</p>	<p>Nga RVB, si dhe në bazë të vizitave të GVJ në UMSH, të gjitha vlerësimet përfundimtare të njohurive për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile janë realizuar nga komisione ku kanë marrë pjesë së paku 2 anëtarë dhe ku</p>



<p>ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>njëri prej tyre është titullari i lëndës/ modulit. Nga procesverbalet e notave vërtetohet përmirësimi i këtij kriteri. Testimi i njohurive zhvillohet nëpërmjet tezave të provimit, të cilat mbanin firmën e titullarit të lëndës dhe Përgjegjësit të Departamentit. Siç pasqyrohet në vendimet e departamentit Komisioni i provimit të një moduli përbëhet nga jo më pak se dy pedagogë. Anëtarët e komisionit të provimit të modulit mbikqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit. (Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 5. Rregullore FSHE; Evidenca 20. Udhëzues Hartim Teze; Konsatim nga GVJ i Tezave të provimit)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Në rregulloren e programit, është përcaktuar qartë, procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët, dhe bëhet në përputhje me programin e studimit. Sipas proces verbaleve, pas provimit final, rezultatet e provimit hidhen në sistem brenda afateve që përcakton udhëzimi për sezonin përkatës të provimeve. Studenti ka të drejtën të njihet me notën dhe vlerësimin përkatës nga ana e komisionit të provimit. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, nëq studentin nuk është dakort me notën ka të drejtë për të bërë një ankesë me shkrim që dorëzohet në sekretarinë mësimore. Kërkesa i drejtohet Dekanit, i cili verifikon situatën. Nëse gjykon që ka pasur gabim ngre një komision për rivlerësimin e tezës së provimit, ose rimerr studentin në provim. (Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH, nen 66; Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI, Nen 18; pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>GVJ konstaton, se kurrikula e programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, është ndërtuar në mënyrë të tillë që të nxisë dhe zhvillojë aftësi profesionale të studentëve në këtë fushë. Struktura e programit është e tillë që lejon harmoni dhe lidhje midis viteve akademike. Në vitin e parë, semestrin e parë jepen lëndë të formimit të përgjithshëm. Duke vazhduar në vitin e parë semestrin e dytë me lëndët bazë të DP, TI&amp;AI, dhe duke përfunduar me vitin e dytë ku thellohen konceptet e marra me anë të lëndëve specifike sipas profileve përkatëse.</p>

	<p>Në përbërje të kësaj kurrkule janë lëndë të tilla si “Teknologji dhe Topologji rrjetash”, “Bazat e Elektroteknikës”, “Sistemet Multimediale” etj. Të gjitha këto lëndë/module janë në funksion të formimit e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh si dhe shumë mundësi të tjera në aktivitete kërkimore shkencore, konsulencë në fushën e biznesit etj. DIFSH-i përgjegjës për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, në koordinim edhe me njësitë e tjera të UMSH-së, përgjatë dy viteve të fundit akademikë, ka garantuar nëpërmjet metodave bashkëkohore thellimin e njohurive dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale të studentëve. (Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Vizita ne Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Bazuar te të dhënat e përgjithshme mbi programin e studimit, DP, TI&amp;AI me profile, si edhe referuar planit mësimor dhe informacionit të marrë gjatë vizitës së GVJ, në institucion vumë re që, programi i studimit DP, TI&amp;AI me profile, përgjatë dy viteve të fundit akademikë, garanton përdorimin e njohurive në fushën e Teknologjisë së Informacionit, si edhe njohuritë në fushën e komunikimit, duke e bërë këtë program më objektiv në përputhje edhe me kërkesën e tregut të njohurive dhe kompetencave. Lëndë të tilla si Bazat e Informatikës, Etikë profesionale &amp; Komunikim, Aplikime Kompjuterike etj, e luajnë më së miri këtë rol. (Evidenca 7. Plan mësimor DP, TI&amp;AI; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar te dokumentacioni i dosjes, RVB, GVJ konstaton se në programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile, njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale plotësojnë tërësinë e kërkesave për formim të studentit në përputhje me diplomën që jep programi. Për mësimin praktik në lëndë të veçanta janë në dispozicion dhe përdoren programe kompjuterike profesionale që sjellin në auditor dhe laboratore situatat praktike (Notepad++, Dev C++, Multisim, Photoshop, Cisco Packet Tracer etj). Për zhvillimin e praktikës është vendosur një marrëveshje midis UMSH-së dhe CODE IT shpk e cila realizohet në ambientet e universitetit. (Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në takim me studentet, GVJ konstaton, se personeli akademik i programit në seancën e fundit përmbyllëse të lëndës/modulit, jep udhëzimet përkatëse në lidhje me provimin final dhe bën konsultimet e duhura me studentët që kanë nevojë për më shumë informacion. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik analizon realizimin e tyre dhe evidenton çështjet më të rëndësishme që lidhen me to. Analizimi i programit të lëndës/modulit në përfundim të tij, temave të leksioneve e seminareve dhe javëve mësimore të</p>



	<p>përcaktuara sipas planit kalendarik, bëhet me qëllim evidentimin e problematikave që lidhen me realizimin e tyre dhe orientimin e studentëve për tu fokusuar më mirë si në përvetësimin e përmbajtjes së programit, ashtu dhe për tu orientuar më mirë në lidhje me përmbylljen e programit me provimin përrundimtar, sipas përcaktimeve në rregulloren e studimeve.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore Programi DP, TI&amp;AI; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH; Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit; Konstatimet nga pyetjet gjate vizites ne institucion)</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në formularin e studentit Alumni, evidentohen të dhënat statistikore te studentëve. Formulari është i ndërtuar në mënyrë që të gjenerojë të dhëna mbi karrierën profesionale dhe punësimin e studentit Alumni, si edhe mbi rolin dhe dobinë e programit të studimit që ai ka ndjekur në UMSH.</p> <p>(Evidenca 22. Formulari i studentit Alumni dhe konsatime nga vizita ne Institucion.)</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>GVJ konstaton se strukturat përkatëse në UMSH-së ndihmojnë dhe orientojnë studentin për kurrikulën e programit të studimit, frekuentimin dhe literaturën. Programi i lëndës i është vënë në dispozicion çdo studenti që orën e parë në auditor nga pedagogu përkatës nëpërmjet syllabuseve të çdo lënde. Personeli akademik dhe strukturat mbështetëse e orientojnë studentin për mënyrën e sigurimit të literaturës. Studentët i përmbyllin studimet e tyre me provim formimi.</p> <p>Gjitashtu, nga vizita në Bilotekën e UMSH, konstatohet se është depozituar program orientues nga departamenti përkatës për këtë provim së bashku me literaturën e nevojshme.</p> <p>(Shtojca nr. 1 "Udhëzues për provimin e formimit, shkurt 2019" datë 01.09.2020, nr prot: 200805, Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE**


<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>GVJ duke shqyrtuar RVB, si dhe nga vizita Institucion, te zyra e Burimeve Njerzore, konstatojmë se, UMSH, ndjek procedura të posaçme në rekrutimin e personelit akademik efektiv (PAE) ashtu edhe me kontratë (PAK) dhe jo vetëm, të cilat janë të pasqyruara në Statut dhe në rregulloren e organizimit të tij. Ky proces starton me evidentimin e nevojës për punonjës nga njësia bazë e departamentit dhe zyrat e UMSH-së, si dhe ndjek të gjitha hallkat e brendshme derisa arrin në shpalljen e vendeve vakante nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-së dhe mjeteve të informimit publik, përzgjedhjes duke përmbyllur procesin me publikimin në faqen zyrtare të UMSH-së. Gjithashtu në bazë edhe të nevojave të institucionit, ai angazhon edhe personel me kohë të pjesshme. Palwt angazhohen me kontratw, ku sanksionohen tw drejtat dhe detyrimet e palwve, sipas kodit tw punes ne Republikwn e Shqiperise.</p> <p>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu VII Neni 57-58, Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH, Kreu V Neni 38 -39; Evidenca 25. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit të stafit; Konsatime nga Vizita GVJ në Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>GVJ në vizitën në UMSH, konstaton se, ZBNJR menaxhon dhe vlerëson performancën e burimeve njerzore dhe përbushjen e kushteve të kontratës dhe respektimin me rigorozitet të ligjshmërisë në punë. Të dhënat për organizimin e programit mbahen në nivel departamenti, në të dy departamentet përgjegjës për programin e studimit, gjatë ndarjes së ngarkesave dhe organizimit të mësimit si dhe në nivel fakulteti. Këto përcillen në ZBNJR-në, e cila vlerëson më pas performancën e burimeve njerzore.</p> <p>(Aneks/1. Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit; Aneks/1. Tabela 6. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Evidenca 3. Rregullore e Organizimit të UMSH. Kreu V Neni 38-39 Konsatime nga Vizita GVJ në zyrën e ZBNJR )</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për</p>	<p>Për të rritur performancën e stafit, institucioni kujdeset për përputhjen sa më të plotë të përshkrimit të vendit të punës me aftësitë individuale të personelit të angazhuar. Në përputhje me objektivat e programeve të studimit personeli akademik angazhohet direkt në organizimin e programit dhe realizimin e planit mësimor. Ndarja e ngarkesës mësimore për personelin akademik bëhet duke ju përshtatur specializimit, eksperiencës në</p>

<p>kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>mësimdhënie dhe gradave e titujve shkencorë të tyre. Personeli akademik është i përfshirë në kërkimin shkencor sipas fushave të interesit duke mundësuar që puna e tyre kërkimore të ndihmojë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit nëpërmjet rishikimit të syllabuseve, përfshirjes në program të njohurive dhe arritjeve më të fundit dhe përditësimit të literaturës së fushës përkatëse.</p> <p>(Aneksi 1. Tabela 6. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ vlerëson faktin që Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka qenë tepër aktiv me stafin e tij akademik me analiza e studime të detajuara mbi situatën e krijuar duke ofruar edhe një sërë zgjidhjesh afatgjata që kërkojnë kontributin e të gjithë aktorëve të shoqërisë.</p> <p>Në faqen zyrtare të UMSH, Rubrika e kërkimit shkencor, janë të ekspozuara botime nga profesorët dhe stafi i universitetit. Kjo dëshmon se një nga prioritetet e UMSH-së është vlerësimi i aftësive të personelit si dhe ngritja profesionale e stafit akademik dhe atij ndihmës.</p> <p>Gjithashtu GVJ, vlerëson arritjet e profesorëve të UMSH në promovimin e librit: “Kriza ekonomike në kohën e koronavirusit” për t, ju përgjigjur situatës aktuale të vendit.</p> <p>UMSH-ja është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS-it, Akademia Europiane e Shkencave dhe Arteve etj. Si anëtar i këtyre rrjeteve, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë bashkëpunon vazhdimisht me institucione akademike në konferenca të përbashkëta dhe me universitetet anëtare të këtij rrjeti.</p> <p>Një nga prioritetet e UMSH-së është vlerësimi i aftësive të personelit si dhe ngritja profesionale e stafit akademik dhe atij ndihmës. Institucioni i mundëson personelit trajnimin sipas fushave të përcaktuara dhe profilit nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Me fokus ngritjen profesionale të personelit akademik, institucioni mbështet pjesëmarrjen në këto aktivitete. UMSH-ja inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet financimit të teksteve universitare dhe të tjera, financimit të botimeve të artikujve dhe konferencave si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave ndërkombëtare nga UMSH-së pa pagesë.</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press">https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press</a>  <a href="https://www.umsh.edu.al/d/162/dy-profesorët-e-njohur-te-umsh-promovojnë-librin-krizaekonomikene-kohen-e-koronavirus">https://www.umsh.edu.al/d/162/dy-profesorët-e-njohur-te-umsh-promovojnë-librin-krizaekonomikene-kohen-e-koronavirus</a></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi godinën e UMSH, ku vërtetoi se Godina, ka 5 kate mbi tokë dhe një nen toke, si dhe një ndertesë 2 katëshe, ngjitur me godinën 5 katëshe.</p> <p>Sipërfaqja totale është 3860 m<sup>2</sup>, për 3060 studente, pra 1.2 m<sup>2</sup>/student, në përputhje me relacionin e verifikimit datë 19.06.2022.</p> <p>UMSH-ja ka vendosur në dispozicion të realizimit të veprimtarive të saj, përkatësisht: 6-salla leksionesh 17 seminaresh dhe 2 laboratore. Sallat janë të pajisura me sisteme kondicionimi, mjete të nevojshme audiovizive, shërbim interneti, mbulim me sinjal wiFi, tabela shpjeguese dhe burime energjie të shumta për të vënë në funksionim pajisjet. Ato plotësojnë të gjitha kërkesat e sigurisë sipas ligjit. Godinat janë të pajisura me salla komode, mjete audiovizive të gjeneratave të fundit dhe laboratorë informatike plotësisht funksionale. Sallat e leksioneve kanë një sipërfaqe prej 100-110 metër katror secila. Pesëmbëdhjetë (15) sallat e seminareve kanë një sipërfaqe prej 35-55 metër katror secila. Laboratorët kanë poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p> <p>(Evidenca 26. Relacion i verifikimit të godinës 2021; Aneksi 1. Tabela 16. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në UMSH, GVJ verifikon se sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratoreve janë të pajisura me mjete audiovizive si kompjutera, projektorë dhe sistem zëri/ fonie. Ato mundësojnë organizimin e video- konferencave, lidhjeve të ndryshme dhe diskutimeve on-line. Njësitë ndihmëse, laboratorët e informatikës, biblioteka me tirazh rreth 15000 libra, laboratorit i gjuhëve të huaja, janë të pajisur me kompjutera të gjeneratave të fundit ku janë instaluar si programet bazike Windows 7, paketa Microsoft Office (instaluar e plotë) edhe programe specifike për realizimin me cilësi të mësimdhënies. Mirëmbajtja dhe përditësimi i pajisjeve kompjuterike dhe programeve të instaluar sigurohet nga Zyra IT-së. Laboratorët kanë poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike sipas specifikave (kompjutera, sistem audio, poste të ndara, etj).</p> <p>(Aneksi 1. Tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line/ Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online Konsatime nga Vizita GVJ në Bibliotekën e Institucionit)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve,</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni siguron kushte optimale për realizimin e aktiviteteve mësimore leksione, seminare, laboratore që lidhen me programet e studimit që ai ofron. Këto përfshijnë infrastrukturën ndërtimore, mjetet dhe pajisjet në të gjitha mjediset e godinave, laboratorët e Teknologjisë së Informacionit dhe laboratorë të tjerë në funksion të programeve të studimit.</p>



aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Vend të veçantë zenë programet profesionale të fushës së IT-së, në funksion të përgatitjes në përputhje me kërkesat specifike të këtij programi studimi, si ato aplikative sipas profilit, TSD (Notepad++, Multisim, Photoshop), TPE (Notepad++, Multisim, Vivado, Photoshop) si dhe SRRK (Notepad++, Multisim, Photoshop). Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Gjate vizites ne UMSH, për punët laboratorike, qw zhvillohen nw 2 laboratoret e Institucionit, në lëndë të veçanta janë në dispozicion dhe përdoren programe kompjuterike profesionale të cilat rrisin në mënyrë eksponenciale njohuritë dhe zbatimin e teorisë së lëndës specifike. Në shërbim të praktikës, është në dispozicion një sallë, e dedikuar për zhvillimin e të gjitha trajtimeve teorike dhe praktike. Këto programe profesionale rishtazi janë bërë pjesë e drejtimeve të lëndëve përkatëse, si rezultat edhe i bashkëpunimit me kompani të specializuara, si TCT, LUFTHANSA. Ato i pajisin të diplomuarit në programin DP, TI&AI me njohuritë që realisht kërkohen në tregun e punës. (Aneksi 2. Syllabuset e lëndëve të programit)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Ne bazë të dokumentacioneve te RVB, dhe vizites ne Institucion, UMSH, ka nje sërë marveshjesh, me Universitete dhe Institucione te tjera, nëpërmjet të cilave sigurohet te realizohen praktikat e studenteve. Gjithashtu DIFSH, ka organizuar një sërë aktivitetesh me specialist/ profesionistë, ne fushen e teknologjisë informacionit ne formen e tavolinave te rrumbullakta, leksioneve te hapura, webinar-eve dhe trajnimeve te ndryshme. Duke u bazuar në strategjinë e programit të studimit, objektivave afatgjatë të mësimnxënies, përshtatjes së vazhdueshme ndaj faktorëve të jashtëm institucionalë dhe kapaciteteve në burime njerëzore, në UMSH, garantohen, mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme për zhvillimin e lëndëve specifike dhe e praktikave profesionale. (Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Aneksi 1 Tabela 5. Lista e marrëveshjeve midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera) ( <a href="https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe">https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe</a> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**

**Kriteret**

**Vlerësimi**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 45

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ vizitoi Bibliotekën dhe sallën e studimit që ndodheshin në ambientet e brendshme të godinës së Universitetit, lehtësisht të aksesueshme për studentët, pedagogët dhe studiuesit.</p> <p>Në Bibliotekë, me një tirazh prej afro 15000 librash dhe publikimesh, ka një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë, që janë të sistemuar në bibliotekën fizike dhe digjitale të UMSH-së. Në bibliotekë ka: literatura, botime periodike, si dhe një librari elektronike me një numër të konsiderueshëm titujsh, shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës.</p> <p>Në Rregulloren e Organizimit të UMSH-së në nenin 30 të saj, sanksionohet se Biblioteka është njësi ndihmëse e Institucionit. Kjo njësi ofron shërbim për të nxitur punën kërkimore shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët.</p> <p><b>Biblioteka Digjitale:</b>  <a href="http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php">http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php</a></p> <p>(Konsultime nga Vizita GVJ në Bibliotekën e UMSH)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Konsultime me Bibliotekën ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, të pedagogëve për kërkim shkencor.</p> <p>Sipas RVB, numërohen mbi 809 artikuj të ndryshëm të fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe jo vetëm, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja në trajtën e literaturave fizike. Ka libra nga autorë të njohur brenda vendit tonë dhe gjithashtu të huaj.</p> <p>Biblioteka e Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” është e pajisur me literaturë bashkëkohore të fushave të ndryshme me rreth 4,441 tituj librash me një numër kopjesh mbi 26,424, të gjitha këto në funksion të programeve të studimit të organizuara sipas fakulteteve.</p> <p>Lidhur me programin e studimit DP, TI&amp;AI, biblioteka e UMSH-së, përmban një numër të konsiderueshëm literaturash dhe kategorizohen në tekste, artikuj shkencore në bibliotekën on-line e cila është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Shërbimi i internetit është edhe në sallën e bibliotekës (edhe si eifi) ku lehtësisht mund të navigohet në faqet e librit elektronik në funksion të programeve të studimit të organizuara në Fakultetin e Shkencave Ekonomike.</p> <p>GVJ konstaton se literatura bazë e programit të studimit të ciklit të DP, TI&amp;AI përbëhet nga tekstet në gjuhën shqipe. Literatura ndihmëse përbëhet nga tekstet në gjuhën shqipe dhe tekste në gjuhët anglisht etj.</p> <p>Nga takimet në DIFSH, informohemi se, në fund të çdo viti akademik bazuar në përvojën e mbledhur, në Departament, diskutohet lidhur me nevojat për ndryshime dhe pasurim të fondit të bibliotekës, në funksion të procesit mësimor, kërkimit dhe punës shkencore. Institucioni siguron përmes Dekanatit informacion të përditësuar nga entet më prestigjioze botuese që operojnë në Republikën e Shqipërisë.</p>



	(Evidenca 17. Material mbi biblioteken, platforma Edëard Elgar Publishing, <a href="https://al.cobiss.net/">https://al.cobiss.net/</a> )
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ vëren se insitucioni siguron kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekën fizike dhe atë digitale. Politikat e UMSH-së janë në mënyrë konstante mbështetëse me fondet monetare të nevojshme për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. Pjesa më e madhe e këtij fondi ka hyrë në bibliotekë në vitet e fundit akademikë duke përditësuar dhe pasuaruar fondin ekzistues në mbështetje të programit të studimit. (Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Nisur nga raporti GVJ, marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni ka me aktorë të jashtëm, shprehin angazhimin UMSH-së, në realizimin e programit mësimor, dhe garanton studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve UMSH garanton, mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. (Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Aneksi 1 Tabela 5. Lista e marrëveshjeve midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera) ( <a href="https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe">https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe</a> )
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Bazuar në pyetjet gjatë takimit në institucion dhe dokumentacionit në zyrën e Financës, dhe në dokumentat e dosjes, GVJ vëren që UMSH ndjek një politikë të kujdesshme të garantimit të qëndrueshmërisë financiare, duke filluar me nevojat e njësive bazë, përgjegjëse për programet e studimit, planifikimi kalon në njësitë përgjatë linjës hierarkike, duke mbërritur në Bordin e Administrimit. Administratori i UMSH-së mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, harton projekt buxhetin vjetor dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit. I hartuar në këtë mënyrë, buxheti vjetor siguron në mënyrë të qëndrueshme financimin e shpenzimeve për realizimin e programit. (Evidenca 1. Statuti i UMSH; Aneksi 1. Përmbledhëse e Tabelave për programin DP, TI&AI me profile: Tabela 18, Pyetjet gjate vizites ne institucion, RVB).
<b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë	Sipas Tabeles së të ardhurave, vizitës në zyrën e Financës, GVJ, konstaton se, procesi i hartimit të buxhetit, respekton rregullat dhe parimet bazë të kontabilitetit dhe administrimit tatimor sipas legjislacionit në fuqi. Ai ka një strukturë të caktuar burimesh dhe shpenzimesh të specifikuar në zërat kryesore dhe garanton paraprakisht shpenzimet kryesore të tij. Burimet financiare kryesore të institucionit janë të ardhurat e realizuara nga kontratat

financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	që lidh institucioni me çdo student. Burim tjetër janë aktivitetet me të tretë dhe financimet nga projektet. Detajimi i shpenzimeve të buxhetit ka në themel nevojat ekonomike të departamenteve si njësi bazë e menaxhimit të aktivitetit të Institucionit.  (Aneksi 1. Tabela 18. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, takime me zyrën e financës)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.4


**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se aktet rregullatore të UMSH, politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik, nga regjistrimi në universitet deri në diplomim, bazohen në Udhëzimet dhe urdhrat përkatës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe rregulloret e Universitetit Metropolitan Tirana. Rregullorja e UMSH-së përshkruan të gjitha politikat dhe procedurat në lidhje me programin e plotë të studimit të ciklit akademik, nga regjistrimi deri në diplomim. Aty përshkruhen kriteret dhe procedurat e regjistrimit, procesi arsimor dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit. UMSH pranon studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes të miratuara (vendimi i senatit për kuotat e pranimit 2020-201) dhe miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.  Përpunimi i të dhënave për studentët bëhet edhe me programe të specializuara që sigurojnë kërkesat ligjore për statistikatat shkollore. Në fillim të vitit akademik, çdo student pajiset me adresën elektronike të brendshme të Institucionit, kodin për t'u futur në platformën SMS dhe që në vit të parë njihet me pedagogun që do të realizojë tutorazhin. Nga ana tjetër, atij i vihen në dispozicion të gjitha mundësitë e kontakteve duke lehtësuar komunikimin e pandërprerë midis studentëve dhe pedagogëve.  Institucioni ka një bazë të dhënash për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, për studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet dhe për ata që prej shumë kohësh nuk janë paraqitur dhe nuk kanë përmbushur detyrimet ndaj saj. Klasifikimi i studentëve sipas ndjekshmërisë, plotësimi të detyrimeve mësimore dhe plotësimi të detyrimeve ekonomike, sigurohet nga sistemi i përpunimit të të dhënave dhe monitorohet nga sekretaria mësimore.  Institucioni nëpërmjet sekretarisë mësimore disponon të dhëna të

	<p>sakta mbi ecurinë e studentëve në këtë program studimi. Këto informacione në letër dhe në formë elektronike japin një pasqyrë të plotë të ecurisë së çdo studenti nga regjistrimi deri në diplomimin e tij. (Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>GVJ konstaton se, procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen duke marrë parasysh vit pas viti përcaktimet bazë ligjore të shpallura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. UMSH-ja, nëpërmjet website dhe rrjeteve sociale zyrtare të tij, mban kontakt të vazhdueshëm me maurantët e rinj duke i informuar ata në kohë reale.</p> <p>Gjatë gjithë periudhës së pranimit dhe regjistrimit të studentëve me vendim rektorati ndërtohen grupe të veçanta që do të presin, shpjegojnë, informojnë dhe shoqërojnë në ambientet e institucionit studentët e rinj.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore e programit DP, TI&amp;AI; Kreu 3, neni 9, 10; Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni RVB, dhe nga vizita e GVJ, konstatohet se, në këtë program studimi, diplomimi bëhet me provim përfundimtar formimi, sipas përcaktimeve në aktet rregullative dhe udhëzuesin për diplomim të UMSH-së shtojca nr. 1 "Udhëzues për provimin e formimit, Shkurt 2019", datë 01.09.2020, nr prot: 200805. Studentët marrin një program orientues për këtë provim së bashku me literaturën e nevojshme, i cili depozitohet nga departamenti përkatës edhe në Bibliotekë.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore e programit DP, TI&amp;AI, Kreu 6, neni 21 Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita GVJ ne UMSH, konstatohet se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës orienton studentët lidhur me mundësitë e punësimit që tregu ofron për profilin e zgjedhur prej tyre. Mbështetja e studentëve nga institucioni bëhet në mënyrë të vazhduar gjatë gjithë ciklit të studimit.</p> <p>UMSH-ja zbaton politika favorizuese punësimit të studentëve edhe brenda institucionit, pas mbarimit të ciklit të tyre respektiv të studimeve. Në UMSH aktualisht gjenden të punësuar studentë që kanë mbaruar studimet në këtë institucion. Konstatohet që, studentë të ekselencës janë pjesë e administratës dhe stafit pedagogjik.</p> <p>(RVB, vizita GVJ)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të</p>	<p>Bazuar në Udhëzimet e MASR-së, institucioni shpall afatet e kryerjes së njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme për studentët e interesuar brenda ose jashtë institucionit.</p> <p>Procedura e transferimit të studimeve dhe studentëve është e</p>

<p>përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>sanksionuar qartë në Rregulloren e Organizimit të UMSH-së, neni 68 dhe 69. Proçedura fillon me paraqitjen e kërkesës pranë Sekretarisë Mësimore, shoqëruar me dokumentacionin ligjor të kërkuar për këtë proces brenda afateve ligjore të shpallura nga Institucioni. Pedagogët dhe sekretaria në rastet e ndryshimit të degëve brenda fakultetit sqaron analitikisht studentët për detyrimet shtesë në programin mësimor dhe kohën e realizimit të tyre. Nga ana tjetër institucioni bën ekuivalentimin e studentëve që vijnë nga Universitete të tjerë brenda apo jashtë vendit. Procedurat e ekuivalentimit realizohen nga komisione të caktuara sipas procedurave të caktuara dhe ligjeve në fuqi. Realizimi i këtij procesi bëhet me vendime të caktuara të Rektoratit dhe Dekanatit. (Evidenca 10. Përmbledhje e procedurës së transferimit të studentëve; Konsatime nga Vizita GVJ në Institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga vizita GVJ në sekretarinë mësimore, çdo student, në fillim të vitit akademik, pajiset me adresë elektronike të brendshme të Institucionit, kodin për t'u futur në platformën e SMS-së dhe që në vit të parë njihet me pedagogun që do të realizojë tutorazhin. Nga ana tjetër atij i vihen në dispozicion të gjitha mundësitë e kontakteve duke lehtësuar komunikimin e pandërprerë midis studentëve dhe pedagogëve. (Pyeqjet gjate vizites ne institucion, RVB).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>GVJ, konstaton se në UMSH funksionon platforma e Sistemit të Menaxhimit të Studentit me akses në faqen zyrtare të institucionit. <a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a>. Me anë të këtij sistemi, çdo student e pedagog pajiset me një llogari personale për të ndërvepruar me sistemin informatik, duke lehtësuar koordinimin e proceseve të mësimdhënies e mësimnxënies midis studentëve dhe stafit akademik e atij ndihmës. Zyra e IT-së bashkëpunon me strukturat e tjera të institucionit për të mundësuar ruajtjen e dokumentacionit të institucionit në version elektronik. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi. Të dhënat mbahen dhe përditësohen elektronikisht, gjithashtu edhe në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar). I gjithë informacioni ruhet në formë të përpunueshme në programet bazë për analiza të hollësishme.</p>



	(Evidenca 12. Udhëzues për përdorimin e SMS, RVB , pyetje nga vizita GVJ ne institucion)
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UMSH-ja ka në dispozicion një sistem informacioni, i cili është Menaxhimi i Sistemit të Informacionit dhe synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Në elementet kryesore të sistemit të informimit përfshihen pajisjet elektronike (hardëare) dhe programet kompjuterike (softëare) që mundësojnë krijimin, përpunimin dhe qarkullimin e informacionit, si edhe strukturat e institucionit që menaxhojnë sistemet.  (Dokumentacioni GVB, konstatim nga vizita GVJ)
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, SMS-ja, është një portal dhe një element funksional i sistemit të informacionit në ndihmë të studentëve dhe pedagogëve. Shumë informacione që jep sistemi janë të shfrytëzueshme me nivele, gjë që garanton një përdorim strategjik të tyre. Sistemi i siguron studentit marrjen e informacionit në mënyrë të vazhdueshme dhe konfidenciale mbi rezultatet e provimeve dhe mbi ecurinë e studimeve. Faqja zyrtare në internet <a href="http://www.umsh.edu.al">www.umsh.edu.al</a> , informon publikun në përgjithësi mbi aktivitetet dhe zhvillimin e Institucionit. (Evidenca 12. Udhëzues për përdorimin e SMS)
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga vizita e GVJ, vërehet se platforma SMS, në UMSH me ndërfaqe aksesit në faqen zyrtare të institucionit, i lejon studentit të shikojë situatën akademike dhe financiare pa patur nevojë të kontaktojë njësitë përkatëse. <a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a> . Gjithashtu, nga eksperiencia në kohën e Covid-19, UMSH, ka të konsoliduar platformat e komunikimit shkencor e administrativ on-line, nëpërmjet G-Suite dhe sistemit Zoom Cloud meeting. Me këtë platformë, gjatë periudhës së pandemisë u zhvilluan cikle diskutimesh problemore (Ëëbinar UMSH Forum) dhe një konferencë shkencore për pasojat ekonomike të pandemisë në botë dhe Shqipëri. <a href="https://ëëë.umsh.edu.al/d/136/konferencë-shkencore-kriza-e-coronavirusit-sfidat-dhe-">https://ëëë.umsh.edu.al/d/136/konferencë-shkencore-kriza-e-coronavirusit-sfidat-dhe-</a>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platforma SMS, realizon raportimin e zhvillimit të mësimt/provimeve/ aktiviteteve të tjera në kohë reale duke lehtësuar punën e të gjithë pjesëmarrësve në marrjen dhe dhënien e informacionit të kërkuar duke ruajtur privatësinë e rezultateve të studentëve. Institucioni ka realizuar informatizimin e tij në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor e shkencor, i gjithë ky sistem është i aksesueshëm edhe jashtë institucionit si nga stafi akademik ashtu edhe nga studentët.  <a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a> .
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku	Konstatohet lehtësisht, UMSH-ja publikon në faqen zyrtare të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. <a href="https://www.umsh.edu.al/">https://www.umsh.edu.al/</a>

të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga vizita GVJ, konstatojmë se UMSH ka procedurë të transferimit të studimeve dhe studentëve të sanksionuara qartë në Rregulloren e Organizimit të UMSH-së, neni 68 dhe 69.</p> <p>Bazuar në Udhëzimet e MASR-së, institucioni shpall afatet e kryerjes së njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme për studentët e interesuar brenda ose jashtë institucionit.</p> <p>Procedura fillon me paraqitjen e kërkesës pranë Sekretarisë Mësimore, shoqëruar me dokumentacionin ligjor të kërkuar për këtë proces brenda afateve ligjore të shpallura nga Institucioni. Pedagogët dhe sekretaria në rastet e ndryshimit të degëve brenda fakultetit sqaron analitikisht studentët për detyrimet shtesë në programin mësimor dhe kohën e realizimit të tyre. Nga ana tjetër institucioni bën ekuivalentimin e studentëve që vijnë nga Universitete të tjerë brenda apo jashtë vendit. Procedurat e ekuivalentimit realizohen nga komisione të caktuara sipas procedurave të caktuara dhe ligjeve në fuqi.</p> <p>Realizimi i këtij procesi bëhet me vendime të caktuara të Rektoratit dhe Dekanatit.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore dhe rezultoni të regjistruar konform rregullave në regjistrin e sekretarisë.</p> <p>(1. Rregulloren e Organizimit të UMSH-së, neni 68 dhe 69, Evidenca 10. Përmbledhje e procedurës së transferimit të studentëve, vizita GVJ në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ pati ballafaqim me zyrën Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës dhe vlerëson politikat e pranimit të studentëve në UMSH, në të gjithë ciklet e studimit, politika të cilat bazohen në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të studentëve nga hyrja në dalje, duke garantuar mundësi të barabarta përmes strukturave në mbështetje të studentëve. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës koordinonin me Zyrën e Marketingut, duke orientuar dhe këshilluar maturantët mbi programet e studimeve, përmbajtjen e tyre si dhe informimin për përzgjedhjet e tyre të ardhshme.</p> <p>(RVB, vizita në UMSH)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të</p>	<p>GVJ konstaton se, për realizimin integral të programit të studimit DP, TI&amp;AI me profile, UMSH-ja ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura në përputhje të plotë me LALKSH 80/2015, me udhëzimet vjetore që dalin nga MARS mbi kriteret e pranimit, si dhe të procesit të Bolonjës. Këto politika konsistojnë në informimin e plotë të studentëve në hyrje mbi programin,</p>


<p>veçanta të programit të studimit.</p>	<p>mësimdhënien, infrastrukturën dhe në dalje duke i këshilluar dhe orientuar për tu integruar në tregun e punës. Këto politika janë të shprehura qartë në Planin strategjik të zhvillimit të UMSH-së, në strategjinë e zhvillimit të vetë programit si dhe në rregulloret e DIFSH-it që realizon këtë program studimi. Për programin e studimit DP, TI&amp;AI me profile nëpërmjet infrastrukturës fizike, virtuale dhe administrative të UMSH-së, ofron për studentët kandidatë dhe studentët që ndjekin këtë program, informim të plotë si në kriteret e pranimit ashtu edhe në atë të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Qartësimi i këtij informacioni bëhet më konkretisht, nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-së, si dhe nga aktivitetet e marketingut digjital (rrjetet sociale të UMSH-së dhe Këshillit Studentor), dhe ai në ambientet e brendshme të UMSH-së. Në këtë proces, një punë e madhe informimi bëhet edhe nga sekretaria, koordinatori i FSHE-së dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH.</p> <p>(Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH; Evidenca 6. Strategjia e zhvillimit të programit DP, TI&amp;AI me profile; Evidenca 2. Rregullore e programit DP, TI&amp;AI)</p> <p><a href="https://ëëë.umsh.edu.al/c/116/teknologji-informacioni-dhe-aplikime-informatike">https://ëëë.umsh.edu.al/c/116/teknologji-informacioni-dhe-aplikime-informatike</a></p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime">https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime</a></p> <p>Vizita në UMSH</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>GVJ vlerëson se, gjithë informacioni në UMSH është i digitalizuar. GVJ, nga vizita në Sekretarinë Mësimore, konkludon se, në fillim të vitit akademik, çdo student pajiset me adresë elektronike të brendshme të Institucionit, (emer.mbiemer), kodin për t'u futur në platformen SMS dhe që në vit të parë njihet me pedagogun që do të realizojë tutorazhin. Nga ana tjetër atij i vihen në dispozicion të gjitha mundësitë e kontakteve duke lehtësuar komunikimin e pandërprerë midis studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Institucioni ka një bazë të dhënash për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, për studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet dhe për ata që prej shumë kohësh nuk janë paraqitur dhe nuk kanë përmbushur detyrimet ndaj saj. Klasifikimi i studentëve sipas ndjekshmërisë, plotësimit të detyrimeve mësimore dhe plotësimit të detyrimeve ekonomike, sigurohet nga sistemi i përpunimit të të dhënave dhe monitorohet nga sekretaria mësimore.</p> <p>Institucioni nëpërmjet sekretarisë mësimore disponon të dhëna të sakta mbi ecurinë e studentëve në këtë program studimi. Këto informacione në letër dhe në formë elektronike japin një pasqyrë të plotë të ecurisë së çdo studenti nga regjistrimi deri në diplomimin e tij. (Vizite GVJ në Institucion, Sekretarinë mësimore)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e</p>	<p>Nga takimi GVJ me studentet, rezulton se ata ishin të mirëinformuar, për kurrikulën e programit të studimit, frekuentimin dhe literaturën. Programi i lëndës i vihet në</p>

<p>aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>dispozicion çdo studenti që orën e parë në auditor nga pedagogu përkatës nëpërmjet syllabuseve të çdo lënde.</p> <p>Studentët, njihen në çdo etapë të studimeve të tyre për hapat dhe detyrimet që kanë gjatë rrugës për diplomimin e tyre. Kjo fillon me Udhëzuesin e Studentit, vazhdon me njoftimet në stendën qendrore të Institucionit dhe me e-maile nga Sekretaria Mësimore, deri në respektimin e dosjes së praktikave dhe procedurave të provimit të formimit. Është një proces që përmbledh përveç strukturave që përmendëm më lart dhe departamentet, pedagogët, sekretarinë, bibliotekën dhe personelin ndihmës. Të gjitha këto struktura nuk kanë vetëm rol informues por edhe ofrojnë ndihmë konkrete për zgjidhjen e problemeve mësimore dhe kërkesave për studime shkencore.</p> <p>Në këtë program studimi diplomimi bëhet me provim përfundimtar formimi, sipas përcaktimeve në aktet rregullative dhe udhëzuesin për diplomim të UMSH-së shtojca nr. 1 "Udhëzues për provimin e formimit, Shkurt 2019", datë 01.09.2020, nr prot: 200805. Studentët marrin një program orientues për këtë provim së bashku me literaturën e nevojshme, i cili depozitohet nga departamenti përkatës edhe në Bibliotekë.</p> <p>(Evidenca 2. Rregullore e programit DP, TI&amp;AI, Takim GVJ me studentët)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ vuri re që UMSH, nëpërmjet website dhe rrjeteve sociale zyrtare, mban kontakt të vazhdueshëm me maturantët e rinj duke i informuar ata në kohe reale. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen duke marrë parasysh vit pas viti përcaktimet bazë ligjore të shpallura nga Ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Gjatë gjithë periudhës së pranimit dhe regjistrimit të studentëve me vendim rektorati ndërtohen grupe të veçanta që do të presin, shpjegojnë, informojnë dhe shoqërojnë në ambientet e institucionit studentët e rinj. Ndër këta pedagogë përfshihen edhe titullarë të strukturave drejtuese me eksperiencë në mësimdhënie dhe me njohje të produktit universitar.</p> <p>(Takime me studentet si dhe pyetje gjate vizites ne UMT, RVB)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të</p>	<p>Nga takimet me stafin e pedagogëve, vizitat e GVJ në zyrën ZKSK-së, sekretarinë mësimore, konsultam se UMSH ka sistem të mirëorganizuar tutorati si strukturë e ngritur me qëllim informimin në mënyrë të hollësishme të studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>



<p>tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Gjithashtu pedagogu i lëndës së bashku me ZKSK-së dhe pedagogun tutor janë strukturat kryesore për orientimin dhe këshillimin e studentëve gjatë ndjekjes së programit të studimit. Përveç tyre në këtë proces janë të angazhuar departamentet, sekretaria dhe gjithë personeli ndihmës. Nga ana tjetër, studentët kanë këndin informativ që mund t'i orientojë dhe t'ju adresojë çdo kërkesë që ata kanë si për problemet e shkollës ashtu edhe për ato jashtë saj.</p> <p>(<a href="https://www.umsh.edu.al/c/116/teknologji-informacioni-dhe-aplikime-informatike">https://www.umsh.edu.al/c/116/teknologji-informacioni-dhe-aplikime-informatike</a>, vizitat GVJ)</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Për praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, UMSH, garanton, mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p>(Evidenca 18. Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me bizneset; Aneks/1 Tabela 5. Lista e marrëveshjeve midis UMSH dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera)</p> <p>( <a href="https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe">https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe</a>)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ organizoi takim me studentet, nga ku konstatojmë se, Në UMSH ka një infrastrukturë, që është e konceptuar të jetë e përshtatshme për të gjithë studentët e UMSH-së, sidomos për studentët e vitit të parë. Për studentët e vitit të parë organizohet prezantimi gjatë së cilës njihen me, sallat e leksioneve, laboratorët, bibliotekën, sistemin e informacionit të UMSH-së, në veçanti SMS-së së UMSH-së, me strukturat ndihmëse: sekretarinë, pedagogun e tutoriatit, strukturat studentore, strukturat këshillimore, të karrierës etj. (Vizita GVJ në institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga takimi me studentet dhe Sekretarinë Mesimore, rezulton se, në fillim të vitit akademik, çdo student pajiset me adresë elektronike të brendshme të Institucionit, kodin për t'u futur në platformën SMS dhe që në vit të parë njihet me pedagogun që do të realizojë tutorazhin. Nga ana tjetër atij i vihen në dispozicion të gjitha mundësitë e kontakteve duke lehtësuar komunikimin e pandërprerë midis studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>(Vizita GVJ në Institucion)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
------------------------	-------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi zyrën e Protokoll-Arkivës, dhe sekretarinë Mësimore, nga ku konstaton, se në UMSH ka një dokumentacion të plotë të dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë (zyrën e sekretarisë mësimore). Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit</p> <p>(Vizita GVJ në UMSH)</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ vizitoi Sekretarinë Mësimore, ku pjesë e arkivës është dokumentacioni që lidhet me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, për studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet dhe për ata që prej shumë kohe nuk janë paraqitur dhe nuk kanë përmbushur detyrimet ndaj saj. Klasifikimi i studentëve sipas ndjekshmërisë, plotësimit të detyrimeve mësimore dhe plotësimit të detyrimeve ekonomike, sigurohet nga sistemi i përpunimit të të dhënave dhe monitorohet nga sekretaria mësimore. (Aneks/1. Tabela 21. Cilesia në hyrje dhe në dalje e studenteve, vizita GVJ ne UMSH)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Sipas RVB, dhe konstatimit të GVJ në UMSH, institucioni nëpërmjet sekretarisë mësimore disponon të dhëna të sakta mbi ecurinë e studentëve në këtë program studimi. Këto informacione në letër dhe në formë elektronike japin një pasqyrë të plotë të ecurisë së çdo studenti nga regjistrimi deri në diplomimin e tij.</p> <p>(RVB, Vizita në Institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në UMSH, funksionon sistemi SMS, i cili menaxhon të dhënat statistikore të studentëve të cilat janë të aksesueshme dhe lehtësisht të verifikueshme dhe vetëm nga personat e autorizuar. Gjithashtu, përveç këtij informacioni në Sekretarinë Mësimore është edhe dokumentacionit fizik i cili disponohet nga ruhet edhe në hard copy.</p> <p>(Konsatime nga Vizita GVJ ne Institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në fazën aktuale, nuk aplikohen të dhëna për punësimin pasi ende nuk është diplomuar brezi i parë. Megjithatë institucioni ka përgatitur një formular studenti Alumni me qëllim që të mbledhë të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar në vazhdim.</p> <p>(Aneks/ 1. Tabela 21 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje; Evidenca 22. Formulari i studentit Alumni)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nga takimi GVJ me studentet, konstatohet se studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor. Ky organizim është bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Statutit të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”, neni 81, pika c. (Evidenca.1 Statuti i UMSH, Vizita GVJ në Institucion)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ mori kontakt me studentët nga ku konstaton se, UMSH-ja garanton përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse. Përfaqësuesit e studentëve në këto organe vendimmarrëse zgjidhen nga Këshilli Studentor. Këshilli Studentor promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH-së, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve si dhe funksionon sipas një rregulloreje të posaçme. Studentët përfaqësohen në forume drejtuese, këshill shkencor, promovime institucionale, etj, sipas rregulloreve të institucionit dhe forumeve përkatëse. Studentët janë të ftuar edhe në shumë aktivitete shkencore apo diskutime për probleme e zhvillime strategjike të institucionit. ( <a href="https://www.umsh.edu.al/d/23/keshilli-studentor">https://www.umsh.edu.al/d/23/keshilli-studentor</a> ) (Evidenca 27. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor, Vizita në Institucion)
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	UMSH, ndjek një politikë në shërbim të studentëve me veprime direkte jashtë burokracisë administrative. GVJ konstaton se, së pari, Sekretaria Mësimore ndihmon për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me mësimdhënien dhe mësimnxënien. Së dyti, element tjetër, që ndihmon në jetën studentore është Tutori për pjesën mësimore dhe ZKSK-ja për pjesën e këshillimit të karrierës, të tregut të punës dhe vazhdimin të studimeve. Elementi i tretë janë pedagogët e lëndëve dhe personeli ndihmës që mundohet t'u krijojë akses në të gjithë elementët e nevojshëm gjatë periudhës studentore. (Takimet e GVJ në Sekretaria Mësimore, personelin akademik, zyren ZKSK)
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	UMSH organizon në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike nga ana e studentëve. GVJ ngjodhi në mënyrë të rastesishme, disa pyetësorë, dhe vëren se, ai organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për çdo program studimi, për të dy ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar pedagogëve të cilëve u bëhen sugjerime. Gjithashtu, nëpërmjet SMS-së studenti ka mundësi të ankimojë rezultatin e arritur brenda afatit të përcaktuar në

	udhëzimin e rektorit mbi zhvillimin e sezonit të provimeve. (Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti. Vizita ne Institucion)			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Në UMSH studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit. Për këtë studenti duhet të kontaktojë me pedagogun tutor për plotësimin e tutoriatit. Më pas kjo i përcillet Pergj. të departamentit dhe zyrës së ZKSK. Pasi realizohet takimi midis studentit dhe pedagogut në rastin e ankimimit, merren masa për zgjidhjen e problemit.  (Evidenca 13. Formular Tutorati. Takimet në Institucion)			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**


Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ konstaton se UMT-ja ka njësi dhe struktura të posaçme që kanë si detyrë të informojnë dhe të kujdesen për studentët gjatë të gjithë vitit shkollor. Organet që janë të ngarkuara për këtë qëllim në UMT, janë: si ZKSK-ja ashtu dhe Zyra e Marketingut.  UMSH-ja ndjek një politikë të përcaktuar qartë për informimin dhe pranimin e studentëve të rinj (maturantëve) në programet e studimeve që UMSH-ja ofron.  Për informacionin e studentëve përdoren të gjitha format dhe mjetet e komunikimit masiv, të gjithë elementet e mundshëm të marketingut digjital, kontaktet direkte me maturantët në të gjithë Shqipërinë si dhe vizita të organizuara pranë institucionit, panairi i punës, etj. (RVB, Vizita ne Institucion)
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në UMSH është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve që funksionon sipas një plani strategjik.  Strukturat e posaçme të ngritura nga Institucioni, përkatësisht Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës në koordinim të plotë me Zyrën e Marketingut, orienton dhe këshillon studentët për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.  (RVB, Vizita në Institucion)
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Nga vizita GVJ në Institucion, ne konstatojmë se pranë UMSH funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK).  Ajo drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit të

<p>informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>tyre universitar, si dhe i orienton dhe këshillon ata për shumë probleme të tjera.</p> <p>Gjithashtu në UMSH, funksionon Këshilli Studentor që ndihmon studentët e vitit të parë të mund të njohin më lehtësisht Institucionin, ti japin zgjidhje problematikave të përditshme dhe t'i ndihmojë ata të integrohen në jetën sociale dhe kulturore të Universitetit. ZKSK-ja ka lidhje të ngushta me subjektet e tregut të punës dhe i ndihmon studentët për të gjetur punë me kohë të pjesshme, të ndërtojnë një CV-i në standarte të caktuara, i këshillojnë për të zgjedhur dhe vazhduar më tej studimet sipas mundësive dhe aftësive, etj. Që në vit të parë, ZKSK-ja me anë të Tutoratit dhe modaliteteve përkatëse, vendos në dispozicion për çdo student një pedagog tutor që ndjek dhe mbikëqyr të gjitha problematikat e tij gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>(Evidenca 27. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor; Evidenca 28. Rregullore e ZKSK; Evidenca 13. Formular tutorati; Vizita GVJ në Institucion)</p>
--	---

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Në këtë program studimi Akoma nuk ka student të diplomuar.</p>
---	---

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



**Përfundime të vlerësimit të programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji Informatike dhe Aplikime Informatike” me profile “Specialist Rrjetesh Kompjuterike”, “Teknik për Pajisje Elektronike” dhe “Teknik për Software dhe Dixhitalizim” i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Staf akademik i kualifikuar dhe i motivuar në përçimin e dijeve. Diversiteti në moshë dhe eksperiencia e stafit akademik, ofron mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave si në aspektin e mësimdhënies ashtu dhe në atë të punës shkencore.
2. Ofrimi i lëndëve teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.
3. Staf akademik i institucionit ka një raport të ngushtë me studentët, si në drejtim të punës mësimore, ashtu dhe ne ofrimin e aktiviteteve jashtë mësimore dhe praktikave profesionale.
4. Infrastruktura e disponueshme, ambiente dhe pajisjet laboratorike për zhvillimin e procesit mësimor. Gjithë veprimtaria e institucionit realizohet në ambiente të përshtatshme me zgjidhje funksionale arkitekturore për çdo element studimor dhe shkencor. Godina është e pajisur me bazën materiale të nevojshme që siguron plotësimin e të gjitha kërkesave, si për detyrimet mësimore të studentëve, ashtu dhe për punën shkencore të stafit akademik.
5. Programi i studimit është në përputhje me një treg pune me hapësirë punësimi në vend dhe jashtë vendit.
6. Përdorimi i platformave online vume re qe rrit cilesine e mesimdhënies, mesimnxënies dhe komunikimit.
7. Bashkëpunimet individuale shndërrohen në marrëveshje institucionale, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencave pozitive në bashkëpunim me të gjithë partnerët, si brenda, ashtu dhe jashtë vendit në funksion të rritjes dhe specializimit të studentëve. UMSH, është pjesë e programeve Erasmus +.
8. UMSH disponon një bibliotekë të pasur me libra fizikë dhe digjitalë, të cilat mundësojnë literaturën për programin e studimit.




**Pika të dobta:**

1. Marketim më i gjerë i programit të studimit dhe përthithja e një numri më të lartë të studentëve.
2. Shtimi i literaturës në gjuhën shqip për programin e studimit.

**Rekomandime:**

1. Të rriten përpjekjet për kualifikimin e stafit akademik me grada dhe tituj shkencorë (me programet e doktoraturës, etj.)
2. Shtimi në vazhdim i nr të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani për praktikat e programit e studimit.
3. Marketim më i gjerë i programit të studimit dhe përthithja e një numri më të lartë të studentëve.
4. Shtimi i literaturës në gjuhën shqipe për programin e studimit, aty ku mundet me libra te rinj.




**Conclusions of the Evaluation: Professional Study Program in "Information Technology and Computer Applications" with profiles "Computer Network Specialist", "Electronic Equipment Technician" and "Software and Digitization Technician" of the Higher Education Institution "Mediterranean University of Albania"**

**Strengths and Affirmations:**

1. Qualified and motivated academic staff in knowledge transmission. The diversity in age and experience of the academic staff offers the opportunity to exchange experiences both in terms of teaching and scientific work.
2. Providing theoretical and practical subjects in accordance with the needs and requirements of the labor market.
3. The academic staff of the institution has a close relationship with the students, both in terms of teaching work and in the provision of extracurricular activities and professional practices.
4. Available infrastructure, premises and laboratory equipment for the development of the teaching process. All the activities of the institution are carried out in suitable premises with functional architectural solutions for every study and scientific element. The building is equipped with the necessary material base that ensures the fulfillment of all requirements, both for the teaching obligations of the students and for the scientific work of the academic staff.
5. The study program is compatible with a job market with employment space in the country and abroad.
6. We noticed that the use of online platforms increases the quality of teaching, learning and communication.
7. Individual collaborations are transformed into institutional agreements, making it possible to exchange positive experiences in cooperation with all partners, both inside and outside the country in function of the growth and specialization of students. UMSH is part of Erasmus + programs.
8. UMSH has a rich library of physical and digital books, which provide literature for the study program.


**Weak points:**

1. Wider marketing of the study program and absorption of a higher number of students.
2. Increasing the number of books in Albanian language for the study program, for different subjects.



**Recommendations:**

1. Increase efforts to qualify academic staff with scientific degrees and titles (with doctoral programs, etc.)
2. Continuing to increase the number of cooperation agreements with companies for study program practices.
3. Wider marketing of the study program and absorption of a higher number of students.
4. Adding literature in the Albanian language for the study program, where possible with new books.

Two handwritten signatures in blue ink are located at the bottom left of the page. The first signature is a stylized, cursive mark, and the second is a more complex, flowing signature.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				X
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

